



1025/3
20.10.21

Nr. 8016/3 Prot.

Tiranë, më 18/10 2021

Drejtuar: **Z. Petrit AHMETI** ✓
Kryetar
Enti Rregullator i Energjisë

Lënda: **Dërgohet Aplikimi për tarifa të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2022.**

I Nderuar Z. Ahmeti,

Ju lutem gjeni bashkëngjitur dokumentin e Aplikimit për tarifa të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2022.

Me konsideratë,

Petra LIKA

Administrator

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A.



APLIKIMI PËR TARIFA TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR NIVEL TENSIONI 2022

OSSH sh.a.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

Adresa : Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023
Tiranë

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE	4
1.1	Vështrim i Përgjithshëm.....	4
1.2	Përlllogaritja e Kërkesës për të Ardhura.....	6
1.3	Përlllogaritja e tarifave të shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni	8
1.4	Indeksi i çmimit të konsumatorit.....	9
1.5	Kursi i Këmbimit Valutor	9
1.6	Aktivitetet në përmirësim të treguesve tekniko-ekonomikë të Shoqërisë	10
II.	PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI	27
2.1	Të Dhënat dhe Metodologjia Bazë.....	27
2.2	Bilanci Energjitik 2021 - 2022	29
2.3	Ulja e humbjeve në Rrjetin e Shpërndarjes	30
2.4	Plani i shpërndarjes në nivel tensioni i klientëve të OSSH 2022.....	31
III.	SHPENZIMET PËR BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE	31
3.1	Shpenzime për blerjen e energjisë për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.	31
3.2	Shpenzime për transmetimin dhe çmimi mesatar i blerjes.....	33
IV.	LLOGARITJA E SHPENZIMEVE OPERATIVE (OPEX)	33
4.1	Përmbledhje për shpenzimet operative.....	33
4.2	Shpenzime për materiale konsumi	34
4.3	Shpenzime për personelin	34
4.4	Shpenzimet për mirëmbajtje.....	34
4.5	Penalitete dhe gjoba	42
4.6	Shpenzimet për shërbime kooperative.....	42
4.7	Marrëdhënie me Publikun	46
4.8	Qera.....	46
4.9	Shërbime Postare dhe Komunikimi	46
4.10	Shpenzime Teknologjia e informacionit.....	46
4.11	Shpenzime Ligjore	46
4.12	Konsulencë dhe Auditim	46
4.13	Të tjera.....	46
I.	ASETET BAZË TË RREGULLUARA	47
1.1	Përlllogaritja e Aseteve Bazë të Rregulluara.....	47
1.2	Investimet (CAPEX)	47
1.3	Kapitali i punës	48
II.	PËRLLLOGARITJA E NORMËS SË INTERESIT TË BORXHIT	49
III.	PESHA MESATARE E PONDERUAR E KOSTOS SË KAPITALIT (WACC)	50

IV.	TË ARDHURAT E KËRKUARA PËR SHPËRNDARJEN E ENERGJISË.....	51
4.1	Të ardhura nga Lidhjet e Reja dhe Energjia Reaktive	52
4.2	Korrigjimi i Të Ardhurave.....	52
V.	PËRLLOGARITJA E TARIFËS PËR NIVEL TENSIONI	53
5.1	Raportet e Shpërndarjes së shpenzimeve dhe të ardhurave	53
5.2	E ardhura e kërkuar për nivel tensioni dhe tarifa	57
VI.	PROPOZIM PËR TARIFAT E SHPËRNDARJES NË NIVEL TENSIONI.....	58
VII.	TARIFA E MIRËMBAJTJES NË ZERO KWH DHE TË TJERA.....	59
VIII.	PLANI I INVESTIMEVE PËR VITIN 2022.....	60
IX.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHOQËRISË.....	66

I. PËRMBLEDHJE

1.1 Vështrim i Përgjithshëm

Detyrimi ligjor për përlogaritjen e tarifës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes bazohet në ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike” Nr. 43/2015 datë 30.04.2015, “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” si dhe Metodologjisë së Përcaktimit të Tarifave të Operatorit të Sistemit Shpërndarjes të Energjisë Elektrike aprovuar nga ERE më 10.11.2017.

OSSH u krijua më 28.03.2018 pas së cilës filloi ngritja e strukturave të saj në mënyrë që të ishte plotësisht funksionale në zbatim të liçencës së shpërndarjes së energjisë. Për arsye të fazës përgatitore të organizimit të OSSH por edhe për shkak të procesit të zgjatur të ndarjes së OSHEE në shoqëri bija, OSSH nuk arriti plotësisht ushtrimin e liçencës së marrë gjatë periudhës 2018 – 2019, e cila ju rikthye përkohësisht OSHEE deri në ndarjen përfundimtare të shoqërisë e cila filloi të funksionojë në fillim të vitit 2020.

Viti 2020 është viti i parë kur OSSH ushtron aktivitet të pavarur në kuadër të zbatimit të ligjit 43/15 “Për sektorin e Energjisë”, ku ndarja ligjore e shoqërisë u krye në fillim të vitit ndërsa përcaktimet funksionale dhe rregullimi i marrdhenieve të Grupit OSHEE u finalizua sipas një Plani Veprimi të detajuar me mbështetje të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ndarja e plotë funksionale gjatë vitit 2020, e cila përfundoi me kalimin e pjesës takuese të asetëve dhe detyrimeve nga shoqëria mëmë OSHEE duke kaluar detyrime të mbartura prej rreth **65 miliard Lekë**, humbje të akumuluar prej rreth **22.6 miliard Lekë** dhe një kapital negativ prej **22.35 miliard Lekë** të cilat shoqëria do të duhet ti përmirësojë gjatë aktivitetit të viteve në vazhdim.

Edhe gjatë vitit 2020 si rezultat i thatësirës sasia e energjisë së furnizuar nga HEC private ishte rreth 21% më e ulët se sasia e planifikuar në fillim të vitit dhe nuk mundi të plotësojë sasinë që i nevojitet OSSH për mbulimin e humbjeve sasi e cila u ble në Tregun e Lirë. Ndërkohë që çmimi i energjisë së blerë në tregun e lirë shënoi rënie për 2020 u ble me çmim mesatar prej 7.26 kwh/Lekë nga rreth 7.65 Lekë që u ble mesatarisht ajo e prodhuar nga HEC-et private dhe prodhuesit e burimeve të rinovueshme energjitike. Blerja e energjisë nga Tregu i lirë favorizoi performancën e OSSH me një efekt pozitiv në uljen e kostos së blerjes së energjisë.

ERE nuk mori parasysh aplikimin për tarifa dhe çmime të OSSH për vitin 2021 dhe nuk mori asnjë vendim duke lënë në fuqi tarifat dhe çmimet e mëparshme. Lënia në fuqi e këtyre vendimeve në kushtet kur nuk ka një vendim të ERE për tarifë të shpërndarjes në tensionin e ulët 0.4 Kv, bëri që OSSH në mungesë të kësaj tarife, e cila përbën 80% e sasisë së volumit të energjisë së shitur, të zbatojë tarifën mesatare të shërbimit të shpërndarjes sipas vendimit të ERE

Nr. 147. datë 26.12.2014. Zbatimi i tarifës mesatare jo vetëm denatyon vlerën e faturuar të shërbimit të shpërndarjes, por edhe krijon ulje në të ardhurat e OSSH të cilat nëse do të ishte marrë parasysh aplikimi do të ishin shumë më të larta dhe rezultati financiar i përmirësuar në mënyrë që të mund të plotësojë nevojat për investime sipas detyrave të miratuara në planin financiar të vitit 2021.

1.1.1 Statusi Ligjor i Shoqërisë

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) është person juridik që funksionon si shoqëri aksionare, organizimi i së cilës bëhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar).

OSHEE është një shoqëri që ushtron aktivitetet në fushën e shpërndarjes së energjisë elektrike i cili është një aktivitet i rregulluar, veprimtaria e së cilit rregullohet nga Ligji 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” në përputhje me politikat rregullatore në sektorin e energjisë elektrike sipas përcaktimeve ligjore të cilat udhëhiqen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).

Shoqëria është krijuar më datë 28 Mars 2018 nga Shoqëria mëmë - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.A. (OSHEE) si pjesë e OSHEE Grup në zbatim të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me qëllim ndarjen e aktivitetit të shërbimit universal të furnizimit për klientët e tregut të rregulluar, nga aktiviteti i shpërndarjes dhe aktiviteti i shitjes në tregun e lirë të energjisë elektrike. Për këtë, bazuar në vendimin e Asamblesë së OSHEE ShA nr.458 dt.15.2.2017 “Për aprovimin e modelit të korporatës,” Ministri i MIE, me urdhërin nr.157 dt.12.2.2018, urdhëroi krijimin e tre shoqërive, ndër ta, krijimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

Me vendimin nr.216 dt.11.10.2018, ERE vendosi transferimin e liçencës së Operimit e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të OSHEE tek OSSH, por, duke vlerësuar ecurinë e procesit të ndarjes së aktivitetit të shoqërisë OSHEE Sh.a. e të konsolidimit të shoqërive të krijuara, si dhe plotësimin e nevojshëm me aktet ligjore e nënligjore, me propozim të aksionerit, ERE me vendimin nr.264 dt.20.12.2018 dhe nr.211 dt.18.12.2019, vendosi që liçensa të bëhet efektive pas një periudhe tranzitore prej 24 muaj, duke saktësuar se gjatë kësaj periudhe, veprimtaria e shpërndarjes së energjisë elektrike vazhdoi të kryhet nga OSHEE sh.a. Duke filluar nga data 1 Janar 2020, shoqëria filloi të ushtrojë normalisht aktivitetin me të gjitha të drejtat operacionale dhe kontraktore si subjekt juridik, sipas liçensimit dhe akteve ligjore në fuqi.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. ka objekt kryesor të aktivitetit shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë

elektrike për sigurimin e përdorimit të energjisë elektrike nga klientët fundorë dhe furnizuesve përdorues të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Ndër objektivat më të detajuara të aktivitetit mund të përmendim:

- Të shpërndajë energji elektrike nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes tek konsumatorët fundorë sipas kontratave të lidhura me FSHU dhe shoqëritë e tjera të furnizimit të licensuara.
- Kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe drejtpërdrejta të lidhura me funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licensën e akorduar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: ndërtimin, funksionimin dhe pronësinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e furnizimit me energji elektrike.
- Lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike.
- Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe bazuar në ndryshimet rajonale apo territoriale të kërkesës.
- Shërbime të tjera për klientët, që janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet ndaj tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe licensat e shoqërisë të lëshuara nga autoritetet kompetente, shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi, apo që ndërvaret ose lidhet me aktivitetet e renditura më sipër.
- Për arritjen e qëllimit të mësipërm, shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari dhe shërbim si për shembull veprimtari tregtare, financiare, arsimore, marketingu, qiradhënie apo hipotekimi, që mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për realizimin e objektit të aktivitetit të Shoqërisë.

Në kryerjen e aktivitetit ekonomik në kushte të rregulluara shoqëria OSSH është e detyruar të zbatojë rregulla të tregut të kontrolluar nga ERE dhe jo ato të tregut të lirë. Të rregulluara janë gjithashtu vlerat e pranuar në llogaritjen e tarifave të shpenzimeve operative dhe kapitale të shoqërisë, në kushte të përlllogaritjes të fitimit të lejuar nga ERE, e cila kontrollon dhe vendos për tarifa të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe çmimet e shitjes me pakicë të energjisë për klientët në tregun e rregulluar.

1.2 Përlllogaritja e Kërkesës për të Ardhura

Në zbatim të metodologjisë e cila bazohet në përlllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara të Operatorit të Shpërndarjes për vitin 2022 janë marrë në konsideratë supozimet themelore si vijon:

- i. Përlllogaritjet e tarifës janë kryer duke marrë parasysh humbjet prej 19.6%. Në situatën krijuar për shkak të Covid-19 si dhe mungesës së të ardhurave për realizimin e

investimeve, OSSH ka kërkuar rishikim të Planit të Konsolidimit i cili është dakortësuar paraprakisht me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe pritet të ndryshohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

- ii. Përlllogaritja e tarifës është kërkuar korrëgjim i tarifës për humbjet e krijuara si rezultat i diferencës në të ardhura që kanë krijuar humbjet e energjisë në rrjet më të mëdha se ato të vlerësuara në llogaritjen e tarifës për periudha të mëparshme. Plani i uljes së humbjeve, të cilat rezultuan më të larta si pasojë e faktorëve të jashtëzakonshëm, u analizuan dhe rivlerësuan me Vendim të Këshillit të Ministrave është marrë parasysh në llogaritjen e korrëgjimit të të ardhurave' ku vlera për tu korrëgjuar prej 14.03 miliard Lekë është propozuar të kompensohet për 5 vjet, pa ndikuar në çmimin final të konsumatorëve.
- iii. Çmimet për Operatorin e Shërbimit të Shpërndarjes me të cilat HEC-et private, prodhuesit nga Burime të Rinovueshme dhe OST i shesin energji dhe shërbim transmetimi OSSH janë supozuar, 7.565 Lekë/Kwh për energjinë e blerë nga HEC private, 12.26 Lekë/Kwh për energjinë e blerë nga prodhuesit nga Burime të Rinovueshme dhe në 0.75 Lekë/Kwh për shërbimin e transmetimit nga OST.
- iv. Energjia për humbjet në rrjet mbulohet nga prodhimi i HEC-eve private dhe nga prodhuesit e Burimeve të Rinovueshme, ndërsa në rastet kur sasia e prodhuar nga ato është më e vogël se sasia e humbjeve në rrjet, diferenca do të blihet në Tregun e Lirë.
- v. Përlllogaritja e shpenzimeve për mbulimin e kërkesës për energji për mbulimin e humbjeve është bazuar në parashikimin e çmimit për vitin në vazhdim, por që në varësi të ndryshimeve në treg mund të jetë gjithashtu objekt i kompensimeve për diferenca në periudha të tjera.
- vi. Zhvillimet e qëndrueshme monetare të ekonomisë Shqiptare, janë marrë parasysh në mosllogaritjen e ndonjë faktori jo pozitiv në provigjionime të mundshme për efekt të raporteve të paqëndrueshme inflative të ekonomisë, që mund të përkthehet në rreziqe të rritjes së menjëhershme të shpenzimeve.

Sasia e energjisë së shpërndarë në rrjet për vitin 2022 parashikohet të jetë 7,581 Gwh. Sasia e energjisë së shitur nga furnizuesit parashikohet të jetë 5,776 Gwh, sasia e energjisë së kthyer nga HEC-et private në rrjetin e OST parashikohet të jetë rreth 320 Gwh dhe sasia e energjisë për mbulimin e humbjeve parashikohet të jetë 1,486 Gwh, duke parashikuar që niveli i humbjeve të jetë 19.6%.

Zbatimi i planit të investimeve sipas planit afatgjatë të aprovuar ka sjellë rezultate në uljen e humbjeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve. Për shkak të problemeve me

likuiditetin shoqëria vendosi të ulë vlerën e investimeve për vitin 2020 në rreth 4.9 miliard Lekë. Investimet janë mbështetur dhe do të vazhdojnë të mbështeten kryesisht në burime të brendshme të shoqërisë (fitimi vjetor i realizuar) si edhe në financimin sipas kredive të buta të akorduara nga institucionet ndërkombëtare. Investimet e parashikuara të kapitalizohen për vitin 2021 janë 14.3 miliard dhe ato për vitin 2022 do të jenë 10.6 miliard Lekë, që do të realizohen me fonde të OSSH si dhe me kredi të akorduara nga Bankat.

Shpenzimet Operative për vitin 2022, në kushte të një shoqërie të re dhe pa shpenzime historike janë llogaritur bazuar në shpenzimet e vitin 2020 dhe ato të buxhetuara për vitin 2021. Menaxhmenti i shoqërisë i ka kushtuar rëndësi të madhe kursimit për çdo zë të shpenzimeve, megjithatë është ndeshur me nevojën e rritjes të disa prej tyre nga viti në vit për të rritur performancën në rehabilitimin e rrjetit dhe uljen e humbjeve. Kostot e humbjeve dhe detyrimeve të trashëguara kanë sjellë shpenzime për penalitete, të cilat rëndojnë shpenzimet operative të kompanisë të cilat sipas metodologjisë nuk janë marrë parasysh në llogaritje.

Në përlllogaritjet në aplikimin për tarifë është propozuar korrigjimi i të ardhurave prej 2.8 miliard Lekë, për kompensim të humbjeve të energjisë elektrike nga diferenca e humbjeve të njohura sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave me humbjet e njohura në tarifë nga ERE për periudhën 2015 – 2021. Humbjet e energjisë në rrjetin e OSSH për këtë periudhë ishin më të larta se ato të njohura në përlllogaritjen e tarifës prej prej 21.04% dhe ky ndryshim i cili ka sjellë rritje të shpenzimeve të blerjes së energjisë prej 14.03 miliard Lekë është kërkuar të korrigohet për një periudhë 5 vjeçare për një total prej 2.8 miliard Lekë në vit.

Nga përlllogaritjet si më poshtë kërkesa për të ardhura për Operatorin e Shpërndarjes në vitin 2022 është rreth 37.1 miliard Lekë.

1.3 Përlllogaritja e tarifave të shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni

Përlllogaritja e tarifës së shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni buron si nevojë e hapjes së tregut në plotësim të kërkesave të ligjit për energjinë si dhe vendimeve të ERE. Duhet theksuar se metodologjia për llogaritjen e tarifës së shpërndarjes përcakton detyrimin e përlllogaritjes së tarifës në nivel tensioni por nuk detajon qartësisht mënyrën e llogaritjes. Metodologjia e përdorur në ndarjen e shpenzimeve dhe përcaktimin e të ardhurave të kërkuara për çdo nivel tensioni është bazuar në shpërndarjen e kostove në bazën e raporteve të alokimit që kanë marrë parasysh: a) vlerën e aseteve në nivel tensioni, b) sasinë e energjisë së shitur në nivel tensioni c) humbjet e energjisë në nivel tensioni dhe d) energjinë reaktive të shitur në nivel tensioni.

Nga përlogaritjet në zbatim të metodologjisë dhe koeficientëve të shpërndarjes (alokimit) rezultojnë se tarifa për tensionin 35 kV duhet të jetë 2.61 Lekë/kwh, për tensionin 20 – 6 kV 3.99 Lekë /kwh dhe për tensionin e ulët 6.63 Lekë/kwh.

1.4 Indeksi i çmimit të konsumatorit


Referuar të dhënave të Institutit të Statistikave INSTAT janë marrë të dhënat e grafikut të mëposhtëm të cilat tregojnë se indeksi i çmimit të konsumatorit për vitin në vazhdim 2021 tenton të jetë rreth 2%.



Megjithë sa më lart mbështetur në të dhënat shumëvjeçare të Bankës së Shqipërisë si dhe në pritshmërinë e treguesve ekonomikë të Shqipërisë në përlogaritjet për tarifë kemi konsideruar një koeficient inflacioni prej 3%.

1.5 Kursi i Këmbimit Valutor

Sipas të dhënave të mëposhtme të marra nga faqja në internet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit EURO/Lekë 2021 si në grafikun më poshtë dhe tendencës për vitin 2021, kursi i këmbimit për energjinë e importit është marrë 1 EURO= 123 Lekë.



1.6 Aktivitete në përmirësim të treguesve tekniko-ekonomikë të Shoqërisë

1.6.1 Treguesit Kryesorë të krahasuar të OSSH gjatë vitit 2020

Treguesit kryesorë të performancës së OSSH të vitit 2020 krahasuar me planin financiar të aprovuar, si dhe ata të bilancit energjistik krahasuar me ato të buxhetuara paraqiten në tabelën më poshtë:

000/Lekë

000/Lekë	Përshkrimi	Janar - Dhjetor 2020	Buxheti Janar-Dhjetor 2020	Diferenca	%
Te ardhurat	Te ardhura nga Shperndarja	26,284,344	31,059,189	↓ (4,774,845)	85%
	Te tjera	655,924	150,293	↑ 505,631	436%
	Gjithsej	26,940,268	31,209,482	↓ (4,269,214)	86%
Shpenzimet	Shpenzime Energji e Blere	11,591,560	11,566,385	↓ 25,175	100%
	Transmetim dhe disbalanca	890,519	1,878,066	↑ (987,547)	47%
	Shpenzime Operative	12,603,063	12,069,148	↓ 533,915	104%
	Provizione	207,300	1,240,315	↑ (1,033,015)	17%
	EBITDA	1,647,826	4,455,568	↓ (2,807,742)	37%
	Amortizimi	3,374,907	2,925,843	↓ 449,064	115%
	Shpenzime Financiare	87,374	363,776	↑ (276,402)	24%
	Tatim Fitimi	466,128	546,338	↑ (80,210)	85%
Gjithsej	29,220,852	30,589,871	↑ (1,369,019)	96%	
REZULTATI I FINANCIAR		(2,280,584)	619,611	↓ (2,900,195)	-368%

ENERGJI (MWH)

	Energji në rrjetin e OSHEE	6,785,136	6,576,790	208,346
	Energji e Humbur ne rrjetin e OSHEE	1,457,740	1,381,126	76,614
Humbje %		21.48%	21.00%	↓ 0.48%

Një analizë e shkurtër lidhur me Treguesit kryesorë të Rezultatit Financiar të OSSH gjatë vitit 2020 krahasuar me Buxhetin paraqitet më poshtë:

- *Rezultati financiar i 2020 shënoi një humbje prej 2,281 milion Lekë:* Megjithë përmirësimet e ndjeshme në drejtim të a) reduktimit të mëtejshëm të humbjeve, b) mbajtjes së shpenzimeve operative në nivele minimale të mundshme c) përmirësimit të cilësisë së shërbimit, mosrealizimi i të ardhurave të planifikuara prej 4.38 miliard Lekë si pasojë e mosndryshimit të tarifave sipas aplikimeve në ERE dhe penalteti prej rreth 2.7 miliard Lekë nga KESH për pagesat e prapambetura të energjisë, shkaktuan një performancë negative që përkeqëson situatën financiare të shoqërisë.
- *Të Ardhura nga Shpërndarja:* Të Ardhurat nga Shpërndarja e Energjisë rezultojnë 15% më të ulta ose rreth 4.8 miliard Lekë në krahasim me ato të planifikuara për shkak të mosaprovimit të ndryshimeve të propozuara në ERE në fund të vitit 2019.
- *Humbjet në rrjetin e Energjisë* për herë të parë pas 5 vitesh të suksesshme, si pasojë e situatës së jashtëzakonshme që krijoi tërmeti i fundivitetit 2019, pasojat e të cilit u shtrinë

edhe gjatë vitit 2020 dhe sidomos situata pandemike e Covid-19 nuk arritën të plotësonin treguesit e planifikuar, duke shënuar një rritje prej 0.48% në krahasim me atë të planifikuar.

- *Shpenzimet për Blerjen e Energjisë* ishin në të njëjtin nivel me ato të buxhetuara ku duhet theksuar se rritja e konsumit për shkak të mosrealizimit të planit të uljes së humbjeve u kompensua nga ulja e çmimit të blerjes në tregun e energjisë.
- *Ulje e shpenzimeve për Transmetim dhe Disbalanca* me një kursim prej rreth 987 milion Lekë është rrjedhojë e planifikimit më të mirë të blerjes së energjisë dhe moskrijimit të disbalancave negative të cilat ishin rreth 43% e atyre të vitit 2019.
- *Shpenzimet për provigjone*, të cilat lidhen kryesisht me provigjone të çështjeve ligjore dhe të dëmit ekonomik ishin rreth 1 miliard Lekë më të ulta.
- *Të ardhura të tjera* u rritën në krahasim me ato të buxhetuara pas faturimit të penaliteteve për mosplotësim të planit të furnizimit me energji elektrike për vitin 2019 sipas kushteve të kontraktimit.
- *Shpenzimet operative për 2020* ishin 4 % më të larta se ato të buxhetuara ose 534 milion Lekë. Të gjitha zërat e shpenzimeve u realizuan sipas parashikimit të buxhetuar me përjashtim të penaliteteve, ku si rezultat i penaliteteve të faturuara nga KESH prej 2.6 miliard Lekë për mospagesa të faturave të energjisë para vitit 2015 shpenzimet në këtë zë u tejkaluan me 1.95 miliard Lekë në krahasim me ato të buxhetuara. Për tu theksuar se nëse nuk do të ishin këto penalitete shpenzimet operative të shoqërisë do të ishin rreth 12% më të ulta se ato të buxhetuara.
- *Pagesat ndaj dy furnitorëve kryesorë*: Pavarësisht vështirësive me likuiditetin OSHEE pagoi ndaj KESH sipas parashikimeve në Planin e Konsolidimit Financiar 100% të faturave vjetore të energjisë së blerë dhe të shërbimit të transmetimit si dhe shleu gjithë detyrimin për pagesat e prapambetura ndaj KESH sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve.
- *Investimet*: Shtesa e aseteve të OSSH për vitin 2020 prej 5,945,727 mijë Lekë përbën vetëm 67% të vlerës së aprovuar të investimeve prej 8,935,241 mijë Lekë. Situata pandemike si edhe ajo financiare për shkak të tarifave të ulta të aplikuar ishin shkaqet e mosrealizimit të investimeve.

1.6.2 Treguesit Kryesorë të krahasuar të OSSH të periudhës Janar - Gusht 2021

Treguesit kryesorë të performancës së OSSH për periudhën Janar – Gusht 2021 krahasuar me planin financiar të aprovuar, si dhe ata të bilancit energjistik paraqiten në tabelën më poshtë:

000/Lekë	Pershkrimi	Janar - Gusht Fakt 2021	Janar-Gusht Plan 2021	Diferenca	%
Te ardhurat	Te ardhura nga Shpërndarja	18,690,395	17,187,462	↑ 1,502,933	109%
	Te tjera	71,294	26,935	↑ 44,358	265%
	Gjithsej	18,761,689	17,214,397	↑ 1,547,291	109%
Shpenzimet	Shpenzime Energji e Blere	9,322,785	7,114,251	↓ 2,208,534	131%
	Transmetim dhe disbalanca	526,988	475,880	↓ 51,108	111%
	Shpenzime Operative	7,735,730	7,170,010	↓ 565,720	108%
	Provizione	-	-	↓ -	-
	EBITDA	1,176,186	2,454,257	↓ (1,278,070)	48%
	Amortizimi	2,052,498	1,683,267	↓ 369,231	122%
	Shpenzime Financiare	51,483	(168,218)	↓ 219,701	-31%
	Tatim Fitimi	115,962	141,081	↑ (25,119)	82%
Gjithsej	19,805,445	16,416,271	↓ 3,389,174	121%	
REZULTATI I FINANCIAR		(1,043,756)	798,126	↓ (1,841,883)	-131%

ENERGJI (MWH)

	Energji në rrjetin e OSHEE	5,154,877	4,653,031	501,846
	Energji e Humbur ne rrjetin e OSHEE	1,102,115	984,532	117,583
Humbje %		21.38%	21.16%	↓ 0.22%

Një analizë e shkurtër lidhur me Treguesit kryesorë të Rezultatit Financiar të OSSH për periudhën Janar – Gusht 2021 krahasuar me Buxhetin paraqitet më poshtë:

- *Rezultati financiar i periudhës Janar-Gusht 2021 shënoi një humbje prej 1,044 milion Lekë: Pavarësisht përmirësimeve në uljen e humbjeve dhe mbajtjes së shpenzimeve operative në nivele minimale të mundshme performanca financiare e shoqërisë ishte negative, për shkak të:*
 - a) Rritjes së shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike me rreth 2.2 miliard Lekë më shumë se planifikimi, për shkak të blerjes së energjisë në tregun e parregulluar për periudhën Korrik – Gusht, me çmime të 2 herë më të larta se ato të planifikuara me një kosto prej rreth 1.7 miliard Lekë si dhe rritjes së sasisë së energjisë së shpërndarë në rrjetin e OSSH.
 - b) Penaliteteve nga efekte ligjore të periudhave të administrimit të mëparshëm si çështja gjyqësore e faturimeve të vitit 2012 me EFT, kur shoqëria ndodhej në administrimin e CEZ.a.s për rreth 881.2 milion Lekë.
- *Të Ardhurave nga Shpërndarja: Të Ardhurat nga Shpërndarja e Energjisë rezultojnë 9% më të larta ose rreth 1.5 miliard Lekë në krahasim me ato të planifikuara për shkak të rritjes së konsumit të energjisë dhe sasisë së energjisë në rrjetin e shpërndarjes ndërkohë që tarifat e aprovuara janë shumë më të ulta se nevojat e shoqërisë për të ardhura.*
- *Humbjet në rrjetin e Energjisë janë duke ecur sipas planit të hartuar tejkalimi i pandjeshëm prej 0.22% gjatë periudhës 8-mujore për shkak të rritjes së konsumit pritet të kompensohet në muajt në vazhdim për të arritur realizimin e planifikuar prej 20.5%*

për vitin 2021

- *Shpenzimet për Blerjen e Energjisë* ishin 2.2 miliardë Lekë më të larta se ato të planifikuara për shkak të blerjes së energjisë në treg për rreth 113 Gwh në periudhën Korrik-Gusht 2021 me çmim mesatar prej 14.7 Lekë/Kwh ose rreth 2 herë më i lartë se ai i planifikuar si dhe rritjes së sasisë së energjisë në rrjet e cila rrit sasinë e energjisë së humbur pavarësisht uljes së normës së humbjeve për njësi në %.
- *Shpenzimeve për Transmetim dhe Disbalanca* u rritën gjithashtu si rezultat i rritjes së sasisë së energjisë së shpërndarë në rrjetin e OSSH me rreth 51 milion Lekë.
- *Shpenzimet operative* për 2021 ishin 8 % më të larta se ato të buxhetuara ose rreth 566 milion Lekë. Të gjitha zërat e shpenzimeve u realizuan sipas parashikimit të buxhetuar me përjashtim të penaliteteve, ku si rezultat i penaliteteve të faturuara nga efekte ligjore të periudhave të administrimit të mëparshëm si çështja gjyqësore e faturimeve të vitit 2012 me EFT, kur shoqëria ndodhej në administrimin e CEZ.a.s për rreth 881.2 milion Lekë.

1.6.3 Ndikimi i rritjes së çmimit të energjisë në performancën e vitit 2021

Si rrjedhojë e mungesës së furnizimit të plotë të energjisë nga HEC-et private për periudhën e mbetur të vitit 2021 parashikohet që OSSH sh.a. do të furnizohet për mbulimin e humbjeve deri në fund të vitit me një sasi prej rreth 60.2 Gwh në tregun e parregulluar. Rritja e çmimit të energjisë në tregun e parregulluar me një parashikim prej 24.9 Lekë/Kwh për periudhën e mbetur të vitit Shtator – Dhjetor 2021 nga 8.05 Lekë/Kwh që ishte parashikuar do të rrisë shpenzimet e blerjes së energjisë për OSSH me rreth 1.014 miliard Lekë të cilat do të ulin më tej performancën financiare dhe vendosin në pozitë të vështirë likuiditetet e shoqërisë.

Performanca financiare e shoqërisë për vitin 2021 si rezultat i të ardhurave të pamjaftueshme nga tarifat e ulta të shpërndarjes së energjisë si dhe si rrjedhojë e rritjes së çmimit të energjisë në tregun e parregulluar pritet të rezultojë me një humbje prej rreth 2.058 miliard Lekë, e cila jo vetëm do të përkeqsojë më tej situatën financiare dhe likuiditetet e shoqërisë, por edhe do të pamundësojë kryerjen e investimeve të nevojshme për uljen e mëtejshme të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.

Masat e marra nga Qeveria e Shqipërisë e cila me VKM nr. Nr. 584, datë 8.10.2021 “ Për Shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike, do të zgjidhin problemet e shoqërisë me problemet e likuiditetit.

Në këto masa (pika 3 e këtij vendimi) është vendosur gjithashtu që OSSH do të ndërpresë investimet e parashikuara për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes me përjashtim të atyre të domosdoshme për furnizimin me energji të konsumatorëve.

1.6.4 Aktiviteti i Shpërndarjes

1.6.4.1 Hyrje

Përshkrimi i Rrjetit

Për të kuptuar vlerat e realizuara të treguesve të cilësisë së furnizimit të rrjetit shpërndarës rëndësi të vecantë ka analiza e strukturës së rrjetit shpërndarës i cili është i vecantë për nga :

1. Numri i madh i niveleve të tensionit 35/10/6/20/04Kv.
2. Shkalla e lartë e amortizimit ne 70% të tij janë pajisje me moshë mesatare mbi 40vjet
3. Nivel i ulët i kabllimit të rrjetit . Në rrjetet 6Kv dhe 10Kv janë përkatësisht 5% dhe 14%. Si i tillë ky rrjet nuk mund të sigurojë tregues të qëndrueshme të cilësisë së furnizimit.
4. Rrjeti 20Kv zë vetëm 16% të totalit dhe ka nivel kabllimi 93%.
5. Në pjesën më të madhe të tij duke përjashtuar rrjetin në qytet Tiranë, Durrës, pak në Fier linjat janë radiale dhe në zonat rurale të thellë me gjatësi shumë të madhe.
6. Në territorin e vendit shtrihet rrjeti 6-10Kv i cili zë rreth 84% të totalit
7. Përdoruesit e rrjetit nuk plotësojnë standartet në pikën e lidhjes duke operuar me pajisje të cilat nuk i nënshtrohen asnjë remonti.
8. Kabinat private të lidhura në rrjet zënë rreth 51% të numrit total të kabinave ndërkohë që këta përdorues ende nuk binden për zbatimin e kodit të shpërndarjes në operim, shfrytëzim, mirëmbajtje.
9. Shpesh në zonat rurale të thella ka linja të cilat janë ndërtuar nga vetë banorët dhe janë jashtë kushteve teknike.
10. Rritja e numrit te HEC-eve të vegjël në zonat ku konsumi është i vogël e ka kthyer rrjetin shpërndarës të paaftë të përmbushë detyrimin sipas liçencës për sigurimin e shpërndarjes me energji elektrike tek përdoruesit.

ALBANIAN POWER SYSTEM



Kategoria e rrjetit shperndares	Te dhenat teknike te rrjetit		Mosha mesatare e rrjetit /pajisje
	Numri	km	
N/stacionet 110/35/20/6 kV	4		38
N/stacionet 110/35/10/6 kV	5		38
N/stacionet 110/35/10 kV	8		38
N/stacionet 110/35/6 kV	8		38
N/stacionet 110/20/6 kV	4		38/15
N/stacionet 110/20/10 kV	2		38/15
N/stacionet 110/20 kV	13		15
N/stacionet 110/10 kV	13		35
N/stacionet 110/6 kV	15		38
N/stacionet 35/10/6 kV	3		40
N/stacionet 35/16/3 kV	1		
N/stacionet 35/10 kV	48		38
N/stacionet 35/6 kV	47		
Rrjeti shperndares 35 kV		1122	40
Rrjeti shperndares 10 kV		7539	40
Rrjeti shperndares 6 kV/		5435	40
Rrjeti shperndares 20 kV		1517	15
Rrjeti shperndares 0.4 kV		28,000	38
Transformatoret 110/35/20/10/6 kV	312		38
Transformatoret 35/10/6 kV			
Transformatoret 20/0.4	4056		
Transformatoret 10/0.4 kV	9524		
Transformatoret 6/0.4 kV	11016		

1. Tabela e niveleve të kabllimit sispas niveleve të tensionit

Linja	Njesia	35kV	20kV	10kV	6kV	0,4kV
Kablllore	km	17.54	2396.88	418.97	763.06	38299.74
Ajrore	km	1244.61	192.43	7528.94	4827.18	17770.72
Niveli i kabllimit	%	1%	93%	5%	14%	68%


1. Tabela e gjatësive të linjave të gjithë niveleve të tensionit sipas zonave

LINJA	Njesia	20kV	10kV	6kV	TOTAL
Urbane	km	1964.03	726.41	715.79	3406.23
Rurale	km	485.77	3907.40	3378.87	7772.04
Rurale e thellë	km	30.00	3122.30	1305.81	4458.10



Problematikat e përmirësimit të rrjetit janë të lidhura me:

1. Kabllimi në 20kv nuk mund të realizohet vetëm në disa vende, ku nga njëra anë asetet janë shumë të vjetëruara, nga ana tjetër, investimet në përmirësimin e rrjetit shmangen veçanërisht nëse një zhvillim dinamik dhe modernizimi rrjetit nuk është ekonomikisht i realizueshëm.
2. Të ardhurat e munguara përgjatë dekadave kanë ulur mundësinë e riparimit të shumë asete që janë instaluar në vitet '50 dhe '60 janë ende në funksion dhe një strukturë rrjeti vetëm me tre nivele tensioni nuk mund të zhvillohet akoma.
3. Me investime të fokusuara, diçka si struktura me tre nivele tensioni mund të arrihet në një periudhë kohore e cila do të jetë pjesë e një studimi, për klientët e zonave urbane dhe rurale me kërkesë konsumi të lartë, kryesisht zona perëndimore e Shqipërisë. Kjo do të garantojë sigurinë e furnizimit dhe me humbje të optimizuara me anë të rrjeteve 110 kv, 20 kv dhe 0,4 kv, kjo për faktin se ekzistojnë nivele tensioni ndërmjetëse të cilat janë trashëgimi historike sikurse është rrjeti 35/10/6kv.
4. Ky drejtim strategjik bazë e rinovimit dhe modernizimit të rrjetit është e njohur për OSSH dhe do të realizohet gradualisht në bazë të investimeve në dispozicion.
5. Rrjeti i sotëm i shpërndarjes planifikohet dhe realizohet në ditët e sotme duke konsistuar në tre nivele tensioni 110 kv, 20 kv (janë në operim edhe tensionet 35 kv ose 10 e 6kv) dhe 0,4 kv. Rrjetet e shpërndarjes me tre nivele tensioni preferohen sepse:
6. Reduktojnë humbjet në rrjet duke shmangur më shumë se dy hapa transformimi brenda sistemit të shpërndarjes.
7. Limitimi i aseteve me tensione të matura të ndryshme për thjeshtëzimin e operacioneve të manovrimit dhe menaxhimit të rrjetit.
8. Reduktimi i kostos bazuar në mundësinë për sasi më të mëdha të aseteve të blera për nivele të njëjta tensioni.
9. Reduktimi i diversitetit të magazinës dhe mbështetja e standardizimit të trajnimit të stafit.



57% e kabinave janë në rrjetin 6-10kV

OSSH është përgjegjëse për:

- përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike,
- sigurimin e zhvillimit të sigurtë dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes;
- mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë territorin për të cilin është liçencuar.

Situata aktuale

Rrjeti Shpërndarës gjatë vitit 2020, me gjithë problematikat e mbartura ndër vite në OSSH sh.a. vazhdon të përballlet me problematikat e mëposhtme:

Vjetërsia e rrjetave dhe pajisjeve:

Shfrytëzimi i një pjese të konsiderueshme të tyre në regjim të mbingarkuar

Për shkak të infrastrukturës së vjetër dhe mbingarkesave të energjisë elektrike, me gjithë investimet dhe përmirësimet që OSSH edhe gjatë periudhës Janar-Shtator 2020, hasi vështirësi në menaxhimin e rrjetit, i cili u reflektua:

- në cilësinë e furnizimit me energji elektrike që i ofroi konsumatorëve,
- në numrin e ndërprerjeve, në kohëzgjatjen e ndërprerjeve,
- në nivelin e humbjeve teknike dhe jo-teknike.

Përdoruesit e Rrjetit Shpërndarës të OSSH janë këto kategori:

- Konsumatorët Fundorë (FSHU),
- Furnizuesit e Liçensuar (për konsumatorët në Treg të Liberalizuar),
- Prodhuesit me Përparësi të Energjisë Elektrike.

1.6.4.2 Analiza e treguesve të performancës së rrjetit për vitin 2020

Kompania OSSH si operator i vetëm i sistemit të shpërndarjes në themel të punës së saj ka për detyrë:

a- të sigurojë një regjistrim korrekt të ndërprerjeve të energjisë elektrike të shkaktuara në sistemin e shpërndarjes, për të pasur tregues të performancës për sa i përket vazhdueshmërisë së furnizimit. Treguesit duhet të jenë të besueshëm, të krahasueshëm dhe lehtësisht të verifikueshëm në mënyrë që informacioni të jetë i saktë për klientët dhe të interesuarit e tjerë lidhur me vazhdueshmërinë e furnizimit;

b- të përmirësojë vazhdueshmërinë e shërbimit të furnizimit në nivel kombëtar dhe për të ulur diferencat ndërmjet zonave të ndryshme të furnizimit;

c- të kufizojë numrin dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve vjetore që pësojnë klientët, duke i siguruar një rimbursim të përcaktuar në rastet e tejkalimit të standarteve specifike të përcaktuara në këtë Rregullore;

OSSH kryen regjistrimin e ndërprerjeve, të gjata apo të shkurtra, nëpërmjet metodave që disponon, nëpërmjet sistemit të regjistrimit të vazhdueshmërisë së shërbimit, duke funksionuar për të gjitha linjat TL dhe TM të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe OSHEE mban regjistrin e ndërprerjeve për të gjitha llojet e ndërprerjeve të përmendura më sipër, i cili përmban:

a- Origjinën e ndërprerjes;

b- Shkakun e ndërprerjes;

c- Numrin e klienteve në TL të përfshirë në ndërprerje;

d- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për secilin klient në TL të përfshirë në ndërprerje;

e- Numrin e klientëve në TM të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;

f- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për secilin klient në TM, të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;

g- Numrin e klientëve në TU, të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive;

h- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për klientët në TU, të përfshirë në ndërprerje dhe numrin e tyre, sipas radhës së rilidhjes, të ndarë sipas kategorive;

i-Datën, orën dhe minutën e fillimit dhe përfundimit të ndërprerjes, për të gjithë klientët të përfshirë në ndërprerje.

j-Cdo ndërprerje e furnizimit me energji elektrike të konsumatorit, në sistemin e shpërndarjes, e cila zgjat më shumë se 10 minuta, konsiderohet ndërprerje e gjatë, e cila regjistrohet dhe përdoret në llogaritjen e treguesve të performancës SAIDI dhe SAIFI.

Koeficienti i ndërprerjes së energjisë elektrike për klient gjatë një viti, përcaktohet duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$SAIFI = \frac{\sum_{i=1}^k N_i}{N_T}$$

SAIFI – (System Average Interruption Frequency Index) koeficienti i ndërprerjes për klient. Kohëzgjatja e përgjithshme e ndërprerjes për klient, që lidhet në ndërprerjet e planifikuara dhe ndërprerjet e gjata të paplanifikuara, përcaktohet duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$SAIDI = \frac{\sum_{i=1}^K D_i \cdot N_i}{N_T}$$

SAIDI - (System Average Interruption Duration Index) koeficienti i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjes për klient.

OSSH në kushtet aktuale ka përmirësuar procedurat për përfshirjen e të gjitha strukturave të operimit të rrjetit në nivel rajonal dhe qendror me qëllim rritjen e saktësisë:

1. Për rregjistrimin në database i të gjithë ndërprerjeve që raportohen çdo tre ore pranë dispecerisë qendrore TM-TU.
2. Kontrolli dhe rregjistrimi i të gjitha ndërprerjeve të shkaktuara në rrjetin HV
3. Përpunimi i informacioneve të mara në forma manual për llogaritjen e treguesve të performancës sipas:
 - Niveleve të tensionit TL dhe TM
 - Sipas Zonave urbane, rurale dhe rurale të thella.
 - Sipas pajisjeve të rrjetit shpërndarës
 - Ndikimi i forcave madhore në qëndrueshmërinë e rrjetit shpërndarës
 - Llogaritja e treguesve për të gjykuar mbi shkallen e amortizimit dhe domosdoshmerinë e kryerjes së investimeve në nyje të ndryshme të rrjetit.
4. Klasifikimi i rrjetit sipas shtrirjes në zona të ndryshme:

- Urban
- Rural
- Rural i thellë

Sektori energjistik vazhdon të përballet me sfida siç janë zhvillimet ekonomike në sektorë të ndryshëm, trendi i konsumit të energjisë për klient etj.

OSSH është përgjegjëse për:

- përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike,
- sigurimin e zhvillimit të sigurtë dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes;
- mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë territorin për të cilin është liçencuar.

Situata aktuale

Rrjeti Shpërndarës gjatë vitit 2020, me gjithë problematikat e mbartura ndër vite në OSHEE sh.a. vazhdon të përballet me problematikat e mëposhtme:

Vjetërsia e rrjetave dhe pajisjeve:

Shfrytëzimi i një pjese të konsiderueshme të tyre në regjim të mbingarkuar.

Për shkak të infrastrukturës së vjetër dhe mbingarkesave të energjisë elektrike, me gjithë investimet dhe përmirësimet që OSSH edhe gjatë periudhës Janar-Shtator 2020, hasi vështirësi në menaxhimin e rrjetit, i cili u reflektua:

- në cilësinë e furnizimit me energji elektrike që i ofroi konsumatorëve,
- në numrin e ndërprerjeve, në kohëzgjatjen e ndërprerjeve,
- në nivelin e humbjeve teknike dhe jo-teknike.

Masat e mara për të siguruar saktësi në monitorimin e treguesve në të gjithë nyjet e rrjetit si në kushtet normale të furnizimit dhe ato në emergjenca, gadishmeri, sezon veror

- Për mbledhjen e të gjithë ndërprerjeve që raportohen cdo tre orë pranë dispecerisë qendrore TM-TU.
- Kontrolli dhe rregjistrimi I të gjitha ndërprerjeve të shkaktuara në rrjetin HV
- Përpunimi i informacioneve të mara në forma manual për llogaritjen e treguesve të performancës sipas:
 - Niveleve të tensionit TL dhe TM
 - Sipas Zonave urbane, rurale dhe rurale të thella.
 - Sipas pajisjeve të rrjetit shpërndarës
 - Ndikimi I forcave madhore në qëndrueshmërinë e rrjetit shpërndarës
 - Llogaritja e treguesve për të gjukuar mbi shkallën e amortizimit dhe domosdoshmërinë e kryerjes së investimeve në nyje të ndryshme të rrjetit.


- Saktesimi i numrit të abonentëve sipas fdrave duke iu referuar të dhënave që meren nga DVT (numri i abonentëve në bazë Rajoni/agjensie/ nënstacioni/fidri/kabine/ .
- Klasifikimi i rrjetit sipas tipologjisë në :
 - Urban
 - Rural
 - Rural i thellë

Realizimi itreguesve 2013 – 2020

Periudha SAIDI

Janar- Dhjetor - 2020	44.12
Janar- Dhjetor 2019	58.79
Janar- Dhjetor 2018	65.18
Janar- Dhjetor 2017	74.43
Janar- Dhjetor 2016	97.07
Janar- Dhjetor 2015 2015	121.95
Janar- Dhjetor 2014	111.82
Janar- Dhjetor 2013	117.50

Perm ne % I SAIDI 2013-2020
62%






Periudha SAIFI



Janar- Dhjetor - 2020	22.90
Janar- Dhjetor 2019	29.90
Janar- Dhjetor 2018	34.02
Janar- Dhjetor 2017	35.6
Janar- Dhjetor 2016	43.15
Janar- Dhjetor 2015	49.1
Janar- Dhjetor 2014	51.9
Janar- Dhjetor 2013	53.5

Perm ne % I SAIFI 2013-2020
57%





Emertimi I rrjetit	SAIFI						SAIDI					
	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Total HV	13.55	8.80	7.75	6.60	6.85	4.60	36.84	18.91	17.60	13.70	14.02	8.28
Total MV	35.53	34.35	27.83	27.42	23.14	18.33	85.11	78.16	56.83	51.48	44.77	35.85
Total OSHEE	49.08	43.15	35.57	34.02	29.99	22.94	121.95	97.07	74.43	65.18	58.79	44.12



Proçesi i modernizimit të rrjetit të shpërndarjes i nisur nga menaxhimi i OSHEE duke filluar në vitet e fundit dhe ato në vijim bazuar edhe në mbështetjen e vazhduar nga MIE /Qeveria Shqiptare si dhe nëpërmjet zhvillimit të projekteve të huaja ka bërë që rrjeti shpërndarës të performojë gjithnjë e më mirë nga viti në vit .

Situata do të përmirësohet gradualisht bazuar në **strategjinë e zhvillimit të rrjetit kabllor 20kV, me aplikimin e kabllove ABC të tensionit të ulet në rrjetin urban të tensionit të mesëm**. Gjithsesi, gjëndja e rrjetit është ende me vlerë shumë të lartë për sa i përket nivelit të SAIFI për tensionin e mesëm (1-2 kliente në vit) ne vendet europiane.

Konkluzion krahasimi për:

Vitet 2015-2020:

SAIDI është përmirësuar ➡ 64% ishte 7317 min bëhet 2647 min

SAIFI është përmirësuar ➡ 53% ishte 49.08 bëhet 22.94

1.6.4.3 Investimet e realizuara për 2020

Investimet në rrjetin e shpërndarjes dhe transformimet që ka pësuar rrjeti:

Transformimi 2012 -2020

	NJESIA/ LLOJI I RRJETIT		2012	2013	2014	
<u>GJATESIA E RRJETIT</u>	km					
<u>Gjatesia e rrjetit te tensionit te mesem</u>	35 kV	~ Ajror	1.111,9	1.111,9	1.111,9	
		~ kabllor	11,4	11,4	11,4	
	20 kV	~ Ajror	76,1	137,0	136,0	
		~ kabllor	1.236,6	1.353,0	1.381,0	
	10 kV	~ Ajror	7.404,1	7.343,0	7.369,0	
		~ kabllor	167,6	169,0	169,0	
		6 kV	~ Ajror	5.072,3	5.112,0	5.154,0
			~ kabllor	291,6	309,0	280,0

	Te tjera(e specifikuar per nivelin e tensionit 16 kV ne Kucove)	~ Ajror	10,1	10,1	10,1
		~ kabllor	0,2	0,2	0,2
Gjatesia e rrjetit te tensionit te ulet	0,4 kV	~ Ajror	25.554,0	25.554,0	25.554,0
		~ kabllor	4.334,0	4.334,0	4.334,0

	NJESIA/ LLOJI I RRJETIT		2015	2016	2017	2018	2019	2020
<u>GJATESIA E RRJETIT</u>	km							
<u>Gjatesia e rrjetit te tensionit te mesem</u>	35 kV	~ Ajror	1.112,8	1.112,8	1.126,6	1126,6	1244,6	1244,6
		~ kabllor	17,5	17,5	17,5	17,5	17,5	17,5
	20 kV	~ Ajror	148,3	146,8	160,9	167,8	190,9	192,4
		~ kabllor	1.429,0	1.653,0	1.895,7	2.101,1	2229,6	2.396,9
	10 kV	~ Ajror	7.471,0	7.463,0	7.482,0	7.402,7	7517,6	7.528,9
		~ kabllor	175,8	181,0	242,9	235,9	197,2	419,0
	6 kV	~ Ajror	5.285,6	5.281,1	5.314,1	5.040,0	4873,2	4.827,2
		~ kabllor	300,3	290,4	290,1	254,8	555,5	763,1
	Te tjera(e specifikuar per nivelin e tensionit 16 kV ne Kucove)	~ Ajror	11,6	11,6	-	-	-	-
		~ kabllor	0,2	0,2	-	-	-	-
<u>Gjatesia e rrjetit te tensionit te ulet</u>	0,4 kV	~ Ajror	22.982,3	21.534,9	20.882,4	19.372,6	18072,8	17.770,7
		~ kabllor	1.668,9	3.626,8	4.313,4	5.600,2	5911,9	6.913,5

1.6.4.4 Mirëmbajtja në rrjetin e shpërndarjes Janar – Dhjetor 2020

Informacioni më poshtë lidhur me shpenzimet e mirëmbajtjes për periudhën Janar – Dhjetor 2020 dhe parashikimin për vitin 2021, sipas relacionit të Divizionit të Shpërndarjes, përfshin shpenzimet kapitale dhe ato operative për mirëmbajtjen e rrjetit të energjisë në OSSH.

Për të siguruar furnizimin me energji elektrike pa ndërprerje duke u bazuar në realizimet e deritanishme të planit të mirëmbajtjes në Drejtorinë TL dhe në Drejtoritë Rajonale, si dhe nga problemet e konstatuara në nyjet kritike realizimi për buxhetin e vitit 2021 për mirëmbajtje ka përfshirë:

- Mirëmbajtjen e N/stacioneve, një pjesë e të cilave janë tepër të amortizuara dhe kanë një ndikim të madh në treguesit e cilësisë së transmetimit dhe në nivelin e humbjeve, zëvendësimin e transformatoreve të fuqisë me moshë mesatare mbi 40 vjeçare.
- Mirëmbajtja nga pikëpamja ndërtimore dhe infrastrukturës së shërbimit në N/stacione, gjëndja e të cilave është tepër kritike pasi provokon difekte të rënda në pajisje dhe nxjerrjen jashtë pune të tyre.
- Mirëmbajtje të linjave 35 kV për rritjen e cilësisë së transmetimit të energjisë elektrike në rrjetin shpërndarës.
- Mirëmbajtje të linjave TM 10 kV, 6kV për rritjen e cilësisë së furnizimit të konsumatorëve.
- Mundësinë e kthimit të linjave më të ngarkuara dhe të gjata, 6 kV në 10 kV duke përdorur strukturën ekzistuese të linjës dhe fuqizuar pjesën e përcjellësave dhe izolacionit e cila mundëson rritjen e fuqisë transmetuese.
- Mirëmbajtjen e kabinave të transformimit TM/TU duke filluar nga pjesa ndërtimore e tyre, mirëmbajtja e pajisjeve komutuese, transformatorëve dhe paneleve TU e cila rrit cilësinë e kushteve teknike të shfrytëzimit të impianteve elektrike shpërndarëse. Zëvendësimin e transformatorëve të fuqisë me moshë mesatare mbi 40 vjeçare dhe prodhim vendi pasi ato kanë humbje të larta në hekur.
- Riparimin e linjave ajrore TM/TU të cilat si pasojë e ndërtimeve pa leje dhe të vendosura në distancë jashtë normave të Sigurisë së Komunitetit dhe të impianteve elektrike janë jashtë kushteve të Rregullores së sigurimit Teknik dhe Shfrytëzimit.
- Mirëmbajtja e linjave furnizuese të objekteve të konsumatoreve të rëndësishëm si : Hidrovore , Spitale , Ujësjiellësa
- Megjithë ndërhyrjet që janë bërë në zëvendësimin e rrjetit TU, nga ai me përcjellës të zhveshur në rrjet TU me kabëll ABC me vetëmbajtje, është e domosdoshme të vazhdojë të bëhet mirëmbajtja e rrjetit TU egzistues të vjetëruar sepse ndikon direkt në vlerat e humbjeve të energjisë duke eliminuar vjedhjen e energjisë por edhe përmirëson dukshëm cilësinë e transmetimit të energjisë si dhe përjashton mundësinë e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjet.

1. Mirëmbajtja në rrjetin shpërndarës 6,10,20,35 kV, mirëmbajtja e rrjetit të vjetër ajror .
2. Mirëmbajtja e nënstacioneve , mirëmbajtja e nyjeve komutuese TL
3. Mirëmbajtja e kabinave elektrike TM/TU, mirëmbajtja e nyjeve komutuese TM .
4. Mirëmbajtja e rrjetit TU, mirëmbajtja e rrjetit të vjetër ajror, mirëmbajtja e nyjeve kritike në rrjetin TU

Më poshtë paraqitet rezultati i shpenzimeve të kryera nga Drejtorite Rajonale dhe Drejtoria TL për vitin 2020.

SHPENZIME PËR MIRËMBAJTJE DHE REMONTE 2020

1	MAKINERI PAISJE	VLERA NE LEKE
		299,189,794
1.1	Nenstacione dhe Linja 35kV	147,496,233
1.2	Rrjet TM dhe Kabina TM/TU	151,693,561
2	BAZE MATERIALE	470,222,982
2.1	Nenstacione dhe Linja 35kV	61,381,926
2.2	Rrjet TM 6,10,20 kV	250,792,961
2.3	Rrjet TU 0.4kV	158,048,095
	TOTAL	769,412,776
1	Riparim I transformatoreve TM/TU- 9 Mujori	432,032,500
2	Riparim I transformatoreve TL/TM - 9Mujori	321,037,155
	TOTAL LEKE	753,069,655

II. PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI

2.1 Të Dhënat dhe Metodologjia Bazë

Të dhënat historike të përdorura në parashikimin e energjisë totale në rrjetin e shpërndarjes dhe konsumit të energjisë për të gjithë konsumatorët e lidhur në rrjetin e shpërndarjes OSSH sh.a janë marrë nga:

- Bilanci Energjistik për vitin 2020 dhe periudhën Janar – Gusht 2021;
- Humbjet Totale, teknike dhe joteknike në nivel Rajoni/Agjensie.

Parashikimi i Energjisë Elektrike është ndërtuar mbi bazën e të dhënave nga përdoruesit e rrjetit të shpërndarjes dhe evolimin e tregut të energjisë. Me detaje këto të dhëna përfshijnë:


- Të dhënat nga FSHU mbi kërkesen për energji elektrike të konsumatorëve fundorë, duke marrë parasysh infrastrukturën e nevojshme që krijon OSSH ndaj klientëve për implementimin e tregut të liberalizuar të energjisë sipas kategorive të ndryshme të lidhur në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2021 deri 2025. Parashikimi OSSH i miratuar edhe nga shoqëritë bija të OSHEE Group me etapat dhe prezumimet si më poshtë:

#	Etapat
1	Duke qenë se OST përfundon projektin e paisjes me matje në distancë për të gjithë përdoruesit e rrjetit të OSSH të lidhur në TM dhe matje TM (në kuadrin e komponentes të tretë të PRP) në qershor 2021, kemi konsideruar 60% të përdoruesve lidhur& matur në TM 20 kv në Zonën Urbane do të kalojnë në treg të lire përgjatë gjysmës se dytë të 2021 (prandaj kanë efekt 30%).
2	Në fund të vitit 2022, OSSH krijon infrastrukturën e plotë për dalje në treg të lirë të çdo përdoruesi të lidhur& matur në TM. Në këto kushte, parashikojmë të kalojnë në treg të lirë 20 kV tërësisht dhe 80% e 10 kV dhe 65% e 6 kV të Zonës Urbane.
3	Në fund të vitit 2023, OSSH krijon infrastrukturën për përdoruesit e lidhur në TU 0.4 kV të furnizuar nga fidera 20 kv për të dalë në treg të lirë. Në këto kushte, parashikojmë të kalojnë në treg të lirë përveç atyre të mbetur të lidhur& matur në TM edhe 60% të përdoruesve të segmenteve Familjarë dhe Komercialë.
4	Në fund të vitit 2024, OSSH krijon infrastrukturën për përdoruesit e lidhur në TU 0.4 kV të furnizuar nga fidera 10/6 kv për të dalë në treg të lirë. Në këto kushte, parashikojmë të kalojnë në treg të lirë përveç atyre të mbetur të lidhur në TU 0.4 kV dhe furnizuar nga fidera 20 kV, edhe përdoruesit e segmentit Familjarë dhe Komercialë të Zonave Urbane.
5	Në fund të vitit 2025, do të kalojë edhe pjesa e mbetur e konsumatorëve e lidhur në TU 0.4 kV të furnizuar nga fidera 10/6 kv (zonat Rurale).

#	Supozime
1	Në asnjë rast sektori publik nuk është konsideruar në treg të lirë. Do të jenë gjithmonë furnizuar nga FSHU.
2	Është marrë parasysh rritje e energjisë sipas dhe rekomandimeve të konsulentëve përgjatë 2021-2025
3	Niveli i humbjeve është sipas pritshmërive të OSSH.
4	Ndarja rurale dhe urbane mund të ketë marzh gabimi, kjo për vetë zhvillimin e qyteteve dhe dinamikës, por mund të përmirësohet në vijim pa ndikuar në parashikimin dhe implementimin e tregut.

- Rezultatet nga raportit i konsulentëve të VPC mbi Load Forecast.
- Plani të investimeve në Rrjetin e Shpërndarjes të cilat planifikohet të japin ndikim në reduktimin e humbjeve gjatë vitit 2022,
- planin që OSSH sh.a ka për reduktimin e humbjeve për vitet 2020-2025

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet trendi i sasisë së energjisë në rrjetin e Shpërndarjes, për vitet 2013-2022:



Metodologjia e re e përlogaritjes së Bilancit (Gross) zbatuar që nga viti 2019, përfshin në totalin e energjisë së hyrë dhe asaj të konsumuar dhe energjinë e kthyer në rrjetin e OST-së nga prodhimi i HEC-ve, e cila për vitin 2022 është parashikuar rreth 320 Gwh.

2.2 Bilanci Energjistik 2021 - 2022

Parashikimet në Bilancin Energjistik të vitit 2022 më poshtë është bazuar në:

- Analizën e të dhënave historike dhe ndryshimet në tregun e shitjes në kushtet e hapjes së tregut të energjisë.
- Në ndikimet që patën faktorët e jashtëm në performancën e punës së shoqërisë gjatë periudhës 2019 – 2021. Duke vlerësuar gjithë situatën e krijuar në periudhën 2019 – 2021 si një periudhë e jashtëzakonshme për shkak të pasojave të tërmetit dhe pandemisë së Covid-19 të cilat në mënyrë të padiskutueshme ndikuan në realizimin e planeve të miratuara nga Qeveria Shqiptare, si në çdo sektor tjetër, OSSH në bashkëpunim me Qeverinë dhe Bankën Botërore janë duke bashkëpunuar për rishikimin e treguesve të humbjes së energjisë elektrike në Planin e Konsolidimit Financiar të Sektorin Elektroenergjitik.

Bilanci energjistik për vitet 2021 – 2022 paraqitet në tabelën më poshtë:


<i>Bilanci energjistik (Mwh)</i>	2021	2022
Energji ne Network	7,492,243	7,581,968
Energji e Blere nga Furnizuesit	7,035,658	6,099,219
Energji e Shitur FSHU	5,500,295	4,612,980
Energji kthyer nga HEC tek OST	376,465	320,000
Energji e Shitur Kliente te tjere	80,120	1,162,750
Humbje Mwh	1,535,362	1,486,239
Humbje %	20.49%	19.60%

2.3 Ulja e humbjeve në Rrjetin e Shpërndarjes

Pavarësisht faktorëve të jashtëm që kanë ndikuar në uljen e performancës së aktivitetit shoqëria i ka vazhduar masat për uljen e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes duke kushtuar kujdes të veçantë në:

- Planifikimin dhe zbatimin e investimeve të domosdoshme në rrjetin e Shpërndarjes
- Sistemimi i kabinave dhe boxe-ve,
- Ndryshimin e matësave nga elektro-mekanik në elektronik,
- Verifikimi i sistemit të matjes,
- Kontrolle të anomalive të evidentuara gjatë procesit të leximit,
- Rritjen e kontrolleve në terren për reduktimin e abuzimeve në rrjet.
- Rritjen e kontrolleve të brendshme me qëllim faturimin sa më korrekt të konsumatorit,
- Aplikimin e Dëmit Ekonomik sipas vendimit të ERE 232/2019 e cila ka për qëllim edhe ndërgjegjësimin e konsumatorit për të mos shpërdoruar Energjinë Elektrike etj.
- Futjen e teknologjive të reja për sistemet e matjes, si MDM, Smart Meter me qëllim leximin dhe faturim sa më korrekt të konsumatorit në harmonizim edhe të rekomandimeve nga projekti Metering Strategy
- Instalimin e Balance Meter të kabinave transformuese duke prioritetizuar zonat me volume më të mëdha të energjisë krahas atyre me performancë të dobët të humbjeve në rrjet.
- Riorganizimi në Rajonet Shpërndarëse Shkodër nën mbikqyrjen e USAID, Durrës, Vlorë etj.

Trendi i përmirësimit të humbjeve 2012 – 2022 paraqitet në tabelën më poshtë:



Total Energji e shitur në rrjetin e shpërndarjes (MWh) 2022

Niveli i Tensionit	Lloji Tensionit	Energji e shitur ne rrjetin e OSSH	Energji e shitur FSHU	Energji shitur në Treg të Lirë
TM	35 Kv	102,336		102,336
TM	20/10/6 Kv	1,060,413		1,060,413
TU	0.4 kv	4,612,980	4,612,980	
TOTAL		5,755,729	4,612,980	1,162,750

III. SHPENZIMET PËR BLERJEN E ENERGISË ELEKTRIKE

3.1 Shpenzime për blerjen e energjisë për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.

Sasia e planifikuar e energjisë që do të blihet për mbulimin e humbjeve në rrjet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2022 parashikohet të jetë 1,486 Gwh. Sasia e planifikuar të blihet do të mbulohet tërësisht nga HEC Ashta 231 Gwh, HEC-et private 1,022 Gwh dhe prodhuesit e energjisë nga Burime të Rinovueshme 43.3 Gwh dhe nga tregu i parregulluar pritet të blihet një sasi energjie prej rreth 190 Gwh.

Parashikimi i Blerjes së energjisë për OSSH paraqitet si vijon:

			2021	2022
Sasi	Energji Gjithsej	Kwh	1,535,362	1,486,239
	Nga KESH	Kwh		
	Nga Ashta	Kwh	304,077	231,264
	Nga HEC private	Kwh	1,015,734	1,022,113
	Nga Burime të Rinovueshme	Kwh	42,425	43,274
	Nga Tregu i Lirë	Kwh	173,126	189,588
Çmim	KESH	Lekë/Kwh	1.50	1.50
	Nga Ashta	Lekë/Kwh	7.45	8.57
	Nga HEC private	Lekë/Kwh	7.45	8.57
	Nga Burime të Rinovueshme	Lekë/Kwh	12.43	12.26
	Nga Tregu i Lirë	Lekë/Kwh	18.24	15.95
	KESH	Lekë	-	-
Nga Ashta	Lekë	2,264,766	1,980,822	
Nga HEC private	Lekë	7,565,190	8,754,600	
Nga Burime të Rinovueshme	Lekë	527,258	530,513	
Nga Tregu i Lirë	Lekë	3,158,024	3,024,060	
Kosto Totale		Lekë	13,515,238	14,289,996

Tarifa e transmetimit	Lekë/Kwh	0.75	0.75
Shpenzime transmetimi	Lekë	701,522	664,679

Çmimi mesatar

8.8	9.6
------------	------------

Skema e furnizimit, pjesë e bilancit energjistik të rrjetit, bazohet në furnizimin e OSSH nga HEC-et private dhe prodhuesit nga Burime të Rinovueshme. Në rastet kur sasia e prodhuar nga HEC-et private është më e vogël se sasia e energjisë së humbur në rrjetin e OSSH diferenca blihet në Tregun e Lirë.

Çmimet e blerjes së energjisë nga HEC-et janë parashikuar të ndryshohen si rrjedhojë e rritjes së çmimit të energjisë në tregun e parregulluar në vlerën maksimale të tyre bazuar në VKM Nr. 687 datë 22.11.2017 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”.

Çmimi I energjisë së prodhuar nga HEC-t private për vitin 2022 parashikohet të jetë 8.57 Lekë/Kwh. Shpenzimet e blerjes së energjisë për OSSH në vitin 2022, i cili pritet të jetë një vit me prodhim normal të energjisë vendase, parashikohet të rriten si rezultat i rritjes së çmimeve të blerjes me rreth 0.755 miliard Lekë në krahasim me vitin 2021, pavarësisht uljes së mëtejshme të humbjeve në rrjet.

3.2 Shpenzime për transmetimin dhe çmimi mesatar i blerjes.

Shpenzimet e Transmetimit për OSSH në vitin 2022 pritet të ulen me rreth 36 milion Lekë në krahasim me ato të vitit 2021.

Tarifa e përdorur në përlllogaritjen e shpenzimeve të transmetimit është parashikuar të bazuar në çmimin aktual për 0.75 Lekë/Kwh. Në përlllogaritje është zbritur sasia e energjisë së furnizuar nga HEC-et private të lidhur në rrjetin e OSSH.

Çmimi mesatar i blerjes së energjisë parashikohet të jetë rreth 9.6 Lekë/Kwh.

IV. LLOGARITJA E SHPENZIMEVE OPERATIVE (OPEX)

4.1 Përmbledhje për shpenzimet operative

Përlllogaritja e Shpenzimeve Operative për vitin 2022 u mbështet në informacionin e shpenzimeve për vitin 2020, në shtesat dhe pakësimet sipas ecurisë së 8-mujorit dhe parashikimet për vitin 2021 si dhe parashikimet vitin 2022 sipas zërave për të gjitha njësitë organizative.

Parashikimi i Shpenzimeve Operative për OSSH bazuar në të dhënat e planifikuara të vitit në vazhdim 2021 ka marrë parasysh rritjen inflative të çmimeve prej 3%, i cili është një parashikim konstant i normuar nga institucionet financiare, si dhe ndryshimeve në strukturën organizative të shoqërisë shoqëruar me ndryshime të shpenzimeve për çdo qendër kostoje. Parashikimi i çdo zëri të tyre është rrjedhojë e analizave të hollësishme të nevojave mbështetur në të dhënat e viteve të kaluara sipas aktiviteteve të ndara, pa përfshirë ndonjë rritje të mundëshme si pasojë e efekteve që mund të kenë akoma ngjarjet nga fatkeqsitë natyrore që ndodhën gjatë vitit 2020, nevojat për të cilat është vështirë të parashikohen dhe do të mund të mbulohen nga ulja e shpenzimeve gjatë vitit.

Parashikimi i shpenzimeve Operative për OSHEE paraqitet në tabelën që vijon:

OSHEE OPEX (000 / Lekë)	2021	2022
	OSSH	OSSH
Shpenzime materiale dhe konsumi	295,800	304,674
Shpenzime për personelin	5,050,122	5,201,625
Mirembajtje	2,676,504	2,756,799
Penalite dhe gjoba		
Sherbime Korporate	1,259,831	1,167,947
Marrdhenie me Publikun	3,000	3,090
Qera	331,849	341,804

Sherbime Postare dhe Komunikimi	15,146	15,600
Shpenzime Teknologjia e informacionit	10,000	10,300
Shpenzime Ligjore	1,000	1,030
Konsulence dhe Auditim	50,000	51,500
Te tjera	861,259	887,097
Totali i Shpenzimeve Operative	10,554,510	10,741,467

Shpenzimet për penalitete nuk janë përfshirë në shpenzimet operative pjesë e përlogaritjes së çmimit të tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike.

4.2 Shpenzime për materiale konsumi

Karburantet zënë peshën kryesore në këtë zë të shpenzimeve për vitin 2022 janë planifikuar bazuar në shpenzimet e pritshme të vitit 2021. Është menduar që sasia e shpenzuar në lloje të ndryshme karburantesh për lëvizjen e mjeteve të shoqërisë të jetë e njëjtë.

Shpenzimet për materiale të tjera janë rritur gjatë vitit 2021 kryesisht lidhur me rritjen e shpenzimeve për veshje pune për punonjësit dhe rritjen e standartit të tyre, e cila pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2022.

4.3 Shpenzime për personelin

Shpenzimet e personelit për vitin 2022 në krahasim me ato të parashikuara për vitin 2021 janë parashikuar të rriten 3% në masën e parashikuar të rritjes së inflacionit sipas kontratës kolektive të punës të lidhur me sindikatat e punonjësve. Në kontratën e punës së punonjësve është parashikuar gjithashtu edhe pagesa e pagës së 13-të e cila nuk u pagua në vitin 2020 për shkak të rezultatit negativ të performancës së shoqërisë.

4.4 Shpenzimet për mirëmbajtje

Shpenzime të mirëmbajtjes për defekte si dhe ato të mirëmbajtjes që ndikojnë në performancë por jo në jetëgjatësinë e aseteve për vitin 2022 janë parashikuar **1,442 milionë Lekë**.

Planifikimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes për vitin 2022 u mbështet në planin e shpenzimeve të vitit 2021 duke marrë parasysh rritjen inflative të çmimeve prej 3%.

Për të siguruar furnizimin me energji elektrike pa ndërprerje duke u bazuar në realizimet e deritanishme të planit të mirëmbajtjes në Drejtorinë TL dhe në Drejtoritë Rajonale, si dhe nga

problemet e konstatuara në nyjet kritike realizimi për buxhetin e vitit 2021 për mirëmbajtje ka përfshirë:

- Mirëmbajtjen e N/stacioneve, një pjesë e të cilave janë tepër të amortizuara dhe kanë një ndikim të madh në treguesit e cilësisë së transmetimit dhe në nivelin e humbjeve, zëvendësimin e transformatorëve të fuqisë me moshë mesatare mbi 40 vjeçare.
- Mirëmbajtja nga pikëpamja ndërtimore dhe infrastrukturës së shërbimit në N/stacione, gjendja e të cilave është tepër kritike pasi provokon difekte të rënda në pajisje dhe nxjerrjen jashtë pune të tyre.
- Mirëmbajtje të linjave 35 kV për rritjen e cilësisë së transmetimit të energjisë elektrike në rrjetin shpërndarës.
- Mirëmbajtje të linjave TM 10 kV, 6kV për rritjen e cilësisë së furnizimit të konsumatorëve.
- Mundësinë e kthimit të linjave më të ngarkuara dhe të gjata, 6 kV në 10 kV duke përdorur strukturën ekzistuese të linjës dhe fuqizuar pjesën e përcjellësave dhe izolacionit e cila mundëson rritjen e fuqisë transmetuese.
- Mirëmbajtjen e kabinave të transformimit TM/TU duke filluar nga pjesa ndërtimore e tyre, mirëmbajtja e pajisjeve komutuese, transformatorëve dhe paneleve TU e cila rrit cilësinë e kushteve teknike të shfrytëzimit të impianteve elektrike shpërndarëse. Zëvendësimin e transformatorëve të fuqisë me moshë mesatare mbi 40 vjeçare dhe prodhim vendi pasi ato kanë humbje të larta në hekur.
- Riparimin e linjave ajrore TM/TU të cilat si pasojë e ndërtimeve pa leje dhe të vendosura në distancë jashtë normave të Sigurisë së Komunitetit dhe të impianteve elektrike janë jashtë kushteve të Rregullores së sigurimit Teknik dhe Shfrytëzimit.
- Mirëmbajtja e linjave furnizuese të objekteve të konsumatorëve të rëndësishëm si : Hidrovore , Spitale , Ujësjellesa
- Megjithë ndërhyrjet që janë berë në zëvendësimin e rrjetit TU, nga ai me përcjellës të zhveshur në rrjet TU me kabëll ABC me vetëmbajtje, është e domosdoshme të vazhdojë të bëhet mirëmbajtja e rrjetit TU egzistues të vjetëruar sepse ndikon direkt në vlerat e humbjeve të energjisë duke eliminuar vjedhjen e energjisë por edhe përmirëson dukshëm cilësinë e transmetimit të energjisë si dhe përjashton mundësinë e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjet.

Ndërhyrjet e mirëmbajtjes në nyjet kritike detajuar më lart në rrjetin e OSSH mund të përmblihen si më poshtë:

- Mirëmbajtja në rrjetin shpërndarës 6,10,20,35 kV, mirëmbajtja e rrjetit të vjetër ajror .
- Mirëmbajtja e nënstacioneve , mirëmbajtja e nyjeve komutuese TL
- Mirëmbajtja e kabinave elektrike TM/TU, mirëmbajtja e nyjeve komutuese TM .

- Mirembajtja e rrjetit TU, mirëmbajtja e rrjetit të vjetër ajror, mirëmbajtja e nyjeve kritike në rrjetin TU

Domosdoshmëria e këtyre shpenzimeve lidhet me nevojat për përmirësime si më poshtë:

Rrjeti shpërndarës TL/TM/TU që menaxhohet nga OSSH sh.a përbëhet nga elementët si vijon:

Nr.	Kategoria e rrjetit shpërndarës	Sasia sipas njesive		Mosha mesatare e Paisjeve/Rrjetit
		Numri	Km	Vjet
1	N/Stacioni 110/35/20/10/6 K v	180		38
2	N/Stacioni 110/20 Kv	15		12
3	Rrjeti shperndares 35 kV		1.262,145	40
4	Rjeti shperndares 10 kV		8.037,32	40
6	Rrjeti shperndares 6kV		5.592,88	40
7	Rrjeti shperndares 20 kV		2.585,86	12
8	Rrjeti shperndares 0.4 kV me percjelles te xhveshur		17.771,178	38
9	Rrjeti shperndares 0.4 kV me kabell ABC		5.018,58	15
10	Rrjeti shperndares 0.k kV kabllor per furnizmin e Bokseve Kolektive, individuale familjare dhe private		33.618,813	25
11	Transformoret 110/35/20/10/6 kV	136		38
12	Transformoret 35/10/6 kV	166		40
13	Transformoret 20/0.4kV	6.323		12
14	Transformoret 10/0.4kV	9.975		35
15	Transformoret 6/0.4 kV	10.027		35

Rrjet TM	Emertimi	Tensioni	Njesia	Sasia	
	Linja ajrore	6 kV	km	4.829,626	
		10 kV	km	7.618,523	
		20 kV	km	192,825	
		35 kV	km	1.244,605	
	Totali Linja ajrore			km	13.885,579
	Linja kabllore	6 kV	km	763,255	
		10 kV	km	418,793	
		20 kV	km	2.393,035	
		35 kV	km	17,54	
	Totali Linja kabllore			km	3.592,623
Totali Linja TM			km	17.478,202	
Rrjet TU	Rrjet shperndares 0.4 kV me percjelles te xhveshur	0.4 kV	km	17.771,178	
	Rrjet shperndares 0.4 kV me kabell ABC	0.4 kV	km	5.018,58	
	Rrjet shperndares 0.k kV kabllor per furnizmin e Bokseve Kolektive, individuale familjare dhe private	0.4 kV	km	33.618,813	
	Totali Linja TU		km	56.408,571	

Siç shihet, rrjeti shpërndarës 35/20/10/6 kV përfshin një gjatësi rreth 17,478.2 km, vjetërsia e të cilit shkon nga 12- 40 vjet. Vjetërsia e rrjetave dhe shfrytëzimi i një pjese të konsiderueshme të tyre në regjim të mbingarkuar ka sjellë që OSSH sh.a të përballet me vështirësi në menaxhimin e rrjetit, vështirësi të cilat janë reflektuar në cilësinë e furnizimit të konsumatorit: numri i ndërprerjeve; kohëzgjatja e ndërprerjeve si dhe në nivelin e humbjeve teknike dhe joteknike.

Më poshtë po ju paraqesim treguesit e cilësisë së furnizimit të konsumatorëve për periudhën Janar-Dhjetor 2020:

Rrjeti shpërndarës	SAIFI	SAIDI
	Nr.i konsumatoreve te prekur nga nderprerjet/Nr. Kons.Gjithsej	Nr.i oreve te nderprerjeve gjithsej/Nr. Konsumatoreve Gjithsej
Janar	1.70	3.74
Shkurt	2.22	5.34
Mars	1.53	2.73
Prill	1.75	3.39
Maj	1.76	2.89
Qershor	1.75	2.94
Korrik	1.86	2.77
Gusht	2.14	3.77
Shtator	1.83	3.95
Tetor	2.47	4.78
Nëntor	1.26	2.08
Dhjetor	2.72	5.84
Total progressive	25.08	47.17

Plani i Shpenzimeve të Mirëmbajtjes Për Vitin 2021 i cili përfshin shpenzime të mirëmbajtjes të cilat nuk rrisin jetëgjatësinë e aseteve prej 1.4 miliard Lekë si dhe pjesën e mirëmbajtjes e cila shkon në rritje të vlerës së aseteve prej 0.695 miliard Lekë paraqitet në tabelën që vijon:

No.	BUXHETI 2021	
I	Drejtoria Rajonale dhe DTL	Vlera (LEK)
	Drejtoria Rajonale të Shperndarjes	
1	Shtylla druri dhe beton arme	120,000,000
2	Kablo Fuqie dhe aksesorë ndihmës per mirembajtje rrjeti kabllor	195,000,000
3	Kabëll ABC dhe aksesorë per mirembajtje te linja e TU	195,000,000
4	Përcjellsa dhe aksesorë per mirembajtje linje ajrore	90,000,000
5	Paisje për mbrojtjen e personelit në punë	65,000,000
6	nyje komutuese TM per remont te kabinave elektrike	170,000,000

7	materiale për punime mirëmbajtje të anëve ndërtimore për ndërtesa përdorimi për kabinat ne nivelet TM;TU	80,000,000
8	Riparim I transformatoreve deri ne 1.8MVA per tension TM/TU	200,000,000
9	Izolatore, Shkarkues TM, Siguresa TM / TU, Baza sigurese TU + fishek, Automat, bokse per matesa per kryerjen e remontit te kabinave elektrike TM/TU	190,000,000
10	Traversa TU dhe TM, qafore shtyllash per remont te linjave ajrore TM dhe TU	55,000,000
11	Riparim paisje per Testim dhe diagnostikimin e Linjave Kabllore TM dhe TU	100,000,000
12	Materiale izolues per mirembajtje per paisje comutuese (SF6,Vaj)dhe transformuese per kabinat elektrike TM/TU	50,000,000
	Shuma 1	1,510,000,000
	Drejtoria e DTL	
1	elemnte te qarqeve primare per mirembajtje N/stacione elektrike te shperndarjes (Transf e N.Stac)	150,000,000
2	elemente per mirembajtje te qarqeve sekondare per N/Stacionet	150,000,000
3	Riparim te transformatoreve TL/TM	155,000,000
4	Materiale izolues per mirembajtje per paisje comutuese (SF6,Vaj)per nenstacionet TL/TM	55,000,000
5	Materiale izolues per mirembajtje per paisje comutuese (SF6,Vaj)dhe transformuese ne N/stac TL /TM	75,000,000
	Shuma 2	585,000,000
	TOTAL (lekë) për Mirëmbajtje OSSH	2,095,000,000

- *Mirëmbajtje N/stacione 110/35/10/6 kV dhe linja 35 kV*

Riparimi i qarqeve sekondare, sistemit të mbrojtjes, kontrollit, sinjalizimit në N/stacione Një nga problemet kryesore të N/stacioneve që administrohen nga OSSH sh. a është funksionimi i mbrojtjes rële i cili është një sektor që paraqet probleme si në N/stacionet e vjetra me pajisje të vjetëruara ashtu edhe në N/stacionet e rinj 110/20 kV ku shpesh ka veprime joselektive të mbrojtjes rële.

Kështu problem paraqesin N/stacionet 110/20 kV Berat, Kusarth, Porto Romano. Në këto N/stacione, relativisht të reja (7-10 vjet) rëletë e mbrojtjes dhe të komandimit kanë dalë jashtë funksionit duke bërë që komutimet e pajisjeve në N/Stacione të mos kryhen automatikisht nga salla e komandës, por manualisht në territor të N/Stacionit duke sjellë shpeshherë probleme. Nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit të Rrjetit është përlogaritur zëvendësimi i rëleve dhe aksesorëve të tjerë për të kthyer mbrojtjen e këtyre N/Stacioneve në gadishmëri të plotë teknike.

Përsa i përket N/stacioneve të vjetër kërkohen zëvendësim kabllosh sinjalizimi dhe komandimi si dhe të rëleve ekzistuese të tyre. Gjithashtu edhe në këto nënstacione do të ndërhyhet duke

blerë dhe zëvendësuar (gjithmonë aty ku është e mundur) me blloqe të rëleve multifunksionale mbrojtje, sinjalizim, komandim, matje.

Nga tabela e buxhetit të parashikuar për vitin 2021 për këto zëra kemi një vlerë prej: 150 milion Lekë.

Referuar gjendjes teknike të rënduar të N/stacioneve, viteve të gjata të shfrytëzimit, dhe amortizimit të tyre megjithëse janë kryer investime të rëndësishme vitet e fundit, në disa prej tyre në pjesën më të madhe të tyre del e nevojshme të ndërhyhet për të zëvendësuar elementë të veçantë të çelësave si : kontakte të lëvizshme, të palëvizshme , izolatorë mbështetës , transformatorë rryme , transformatorë tensioni si dhe aksesore të tjerë përbërës të skemës primare të N/stacioneve.

Të gjitha këto elementë përbëjnë nyjet kritike të cilat kërkojnë domosdoshmërinë e ndërhyrjes për normalizimin e tyre.

Nga tabela e buxhetit të parashikuar për vitin 2021 për këto zëra kemi një vlerë prej: 150 milion Lekë.

- *Hidroizolimi N/stacione; kabina transformacioni*

Siç jemi shprehur edhe më parë, gjendja teknike e vështirë e rrjetit, vjetërsia e tij, mungesa e remonteve të mesme dhe investimeve ka sjellë ndër të tjera edhe probleme në anën konstruktive-ndërtimore të ndërtesave të N/stacioneve dhe kabinave të transformacionit.

Problemet e pamjaftueshmerisë së hidroizolimit në ndërtesat e N/stacioneve dhe kabinave kanë sjellë problem edhe në përkeqësimin e kushteve teknike të shfrytëzimit të pajisjeve që janë të instaluar në këto ndërtesa si: Çela TM; Thika TM; Celësa TM; transformatorë fuqie; panele TU etj si dhe mund të krijojnë precedent për ndodhjen e emergjencave në objekt si: rrëzime muresh, tavani duke sjellë si pasojë edhe rrezikimin e jetës së punonjësve ose komunitetit.

Përsa më sipër janë identifikuar objektet me probleme të hidroizolimit në ndërtesat e N/stacioneve dhe kabinave të transformacionit sipas DTL dhe Drejtorive Rajonale.

Nga tabela e buxhetit të parashikuar për vitin 2021 për këto zëra kemi një vlerë prej: 80 milion Lekë.

- *Mirëmbajtje dhe remonte në linjat ajrore 20/10/6 kV,*

Nga monitorimi i rrjetit shpërndarës është vërejtur se rreth 100 (Nga afërsisht 1200 fidera që janë gjithsej) janë me probleme të natyrave të ndryshme si;

Amortizim i përcjellësit

Gjatësi e madhe mbi 50 km

Mbingarkesë për një kohë të gjatë për shkak të amortizimit të përcjellësit dhe seksionit jo të përshtatshëm për transmetimin normal të energjisë sipas parametrave teknik.

Rritjes në vazhdimësi të kërkesës për energji elektrike.

Një regjim i tillë pune ka sjellë rritjen e humbjeve teknike në rrjet si dhe vjetërimin më të shpejtë të këtyre rrjetave duke sjellë si pasojë punimin e tyre jashtë kushteve teknike të shfrytëzimit dhe sigurimit teknik. Gjithashtu në këto rrjeta treguesit e performancës (SAID dhe SAIF) janë në parametrat më të këqinj. Përsa më sipër, duke qenë se këto fidera janë të vendosur dhe furnizojnë veçanërisht zonat rurale sugjerohet të ndërhyhet në kryerjen e remonteve të mesme dhe të thella duke:

Zëvendësuar përcjellësat dhe aksesorët e tyre

Nga tabela e buxhetit të parashikuar për vitin 2021 për këto zëra kemi një vlerë prej: 90 milion Lekë

Zëvendësuar shtyllat e dëmtuara

Nga tabela e buxhetit të parashikuar për vitin 2021 për këto zëra kemi një vlerë prej: 120 milion Lekë

Zëvendësuar izolacionin (traversa TM , izolatore TM)

Nga tabela e buxhetit të parashikuar për vitin 2021 për këto zëra kemi një vlerë prej: 55 milion Lekë

Zëvendësuar izolatorët TM/TU, Shkarkuesa TM, Siguresa TM/TU, automate etj.

Nga tabela e buxhetit të parashikuar për vitin 2021 për këto zëra kemi një vlerë prej: 190 milion Leke. Gjithashtu këtu përfshihen edhe paisjet (nyjet) komutuese për remont të kabinave (Celat 20 kV).

Nga tabela e buxhetit të parashikuar për vitin 2021 për këto zëra kemi një vlerë prej: 170 milion Lekë

Në vijim, përveç kryerjes së remonteve të mesëm në linjat e sipërpërmendura (rreth 100 Fidera) do të vazhdojë kryerja e remonteve të mesëm dhe profilaktike edhe në gjithë pjesën tjetër të rrjetit ajror TM duke pasur parasysh që nëse është e mundur të kthejmë edhe izolacionin nga 6 dhe 10 kV në 20 kV në mënyrë që të rrisim mundësinë e transmetimit të energjisë dhe të zvogëlojmë nivelin e humbjeve teknike në rrjet.

Kryerja e remonteve të mesme dhe profilaktike në të gjitha fidera e Tensionit të Mesëm Ajror, tashmë të shtrirë këto remonte gjatë gjithë vitit do të rrisë cilësinë e furnizimit me energji të konsumatorit si dhe do të ketë efekt në zvogëlimin e humbjeve teknike dhe joteknike.

- *Mirëmbajtje linje kabllore TM 20/10/6 kV*

Rrjeti kabllor TM përfshin nivelet 20/10/6 kV. Në qytetet kryesore të vendit aty ku edhe kërkesa për energji elektrike është më e lartë janë ndërtuar rrjeta shpërndarës TM 20 kV, ndërsa në qytetet më të vogla furnizohen nga rrjeta kabllore 10/6 kV, mjaft prej të cilave janë në kablo të armuara. Është për tu theksuar se gjatë viteve të tranzicionit shumica e këtyre rrjetave janë dëmtuar jo vetëm elektrikisht për shkak të kushteve të shfrytëzimit dhe vjetërsisë së tyre, por edhe mekanikisht nga palë të treta.

Një tjetër problem me të cilin përballlet shfrytëzimi i rrjetave kabllore TM është edhe zënia e trasesë së tyre nga ndërtime pa leje, të cilat kanë sjellë jo vetëm dëmtimin e tyre por në rast avarie edhe probleme të tjera që lidhen me shpenzime për zhvendosjen e trasesë së këtyre fiderave.

Plani i Mirëmbajtjes së vitit 2021 parashikon edhe mirëmbajtjen e rrjetave kabllore TM 20/6/10 kV, e cila konsiston në: Zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara kabllore në kolektorët dalës të N/stacioneve.

Zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara të kabllave në trotuare dhe rrugët kryesore të qyteteve, pamundësia e riparimit të të cilave deri tani ka sjellë që skema e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve të humbasë fleksibilitetin dhe të rritet kohezigjatja e mbetjes pa energji të konsumatorëve dhe për më tepër energjia e pafurnizuar në rrjet.

Zhvendosjen e kabllave nga trasetë tashmë të zëna nga objektet familjare dhe privatë në trase të reja për të mundësuar shfrytëzimin e rrjetit kabllor brenda kushteve teknike dhe Rregullores së Shfrytëzimit dhe Sigurimit Teknik.

Në total për Mirëmbajtjen e Rrjetit Kabllor 35/20/10/6 kV për vitin 2021 janë parashikuar një vlerë për kablo dhe gjithë aksesorët e tyre rreth: 195 milion Lekë

- *Mirëmbajtje linje kabllore TU, mirëmbajtje kabina transformacioni TM/TU, zëvendësimi i përcjellësave të zhveshur me kabëll ABC*

Në studimin në lidhje me humbjet teknike në rrjetin shpërndarës të OSHEE sh.a kryer nga PwC në vitin 2010 rezulton se gjysma e humbjeve teknike totale (19.2%) është përqëndruar në rrjetin shpërndarës TU, i cili është ndërtuar në kategoritë; ajror dhe kabllor.

Duke qenë se gjatësia e rrjetit ajror TU është rreth 17,770 km, shumica e të cilit ka një vjetërsi prej rreth 38 vjetesh si dhe niveli i humbjeve teknike dhe joteknike është shumë i lartë atëherë në Planin e Mirëmbajtjes është parashikuar kryerja e remonteve të mesëm në rrjetat ajrore dhe kabllore TU, veçanërisht në kabinat ku do të instalohet matja AMI si dhe në zonat periferike të qyteteve të medha dhe ato rurale, nëpërmjet:

Zëvendësimin të përcjellësave të zhveshur ajrore me kabëll ABC efektiviteti i të cilit është shumë i lartë në:

Zvogëlimin e humbjeve joteknike

Zvogëlimin e humbjeve teknike

Përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve

Përmirësimin të izolacionit (zëvendësimin të izolatoreve TU, zëvendësimin të traversave TU etj)

Riparimit të gjendjes së kabllave TU në kabina dhe në daljet kabllore TU duke bërë të mundur instalimin e tyre brenda kushteve teknike të shfrytëzimit dhe Rregullores së Shfrytëzimit dhe Sigurimit Teknik. Kjo punë do të përqëndrohet veçanërisht në kabinat në të cilat do të instalohen matësat e teknologjisë së lartë AMI

Riparimit të gjendjes teknike të kabinave të transformacionit TM/TU në pjesën TM: Çela TM, Thika TM, Thikë-siguresa transformatori, transformatori i fuqisë, panel TU' veçanërisht në kabinat ku do të instalohet matja AMI.

Riparimi i dyerve të kabinave dhe mbyllja e tyre me çelës.

Simetrizim i ngarkesës në transformatorët e fuqisë duke ndërhyrë në rrjetin shpërndarës TU ajror dhe atë kabllor, veçanërisht në bokset kolektive.

Në Planin e Mirëmbajtjes është parashikuar një vlerë 195 milion Lekë, e cila përfshin instalimin e kabllit ABC, aksesoreve të tij.

Paisje për mbrojtëse e personelit në punë dhe aparate matëse (Pllaka, tregues, tapet dielektrik, shtangë manovrimi, doreza mbrojtëse, galloshe mbrojtëse, këmbaleca, rripa, litar, shirit, jelek, këpucë, çizme, dhe aksesore të tjera të nevojshëm

Në planin e Mirëmbajtjes për vitin 2021 për një mbarëvajtje normale dhe të suksesshme dhe në përputhje me Normat dhe Regullat e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik është parashikuar edhe zëri i mësipërm, me një vlerë 65 milion Lekë.

Se fundmi theksojmë, qe per te permiresuar treguesit rrjetit te shperndarjes se energjise elektrike (SAID dhe SAIF) eshte shume e rendesishme permiresimi i metodave dhe menyres se gjetjes dhe riparimit te linjave TM/TU ajrore dhe kabllore.

Per kete ne buxhetin e vitit 2021 jane parshikuar: 100 Milion Leke te cilat do te sherbejne per permiresimin e teknologjise dhe paisjeve te gjetjes se difektit dhe riparimit te tij.

Gjithashtu, materiale izoluese (SF6,vaj) per remonte e mirmbajtje te pajisjeve komutuese e transformuese ne kabina, eshte parashikuar vlere 50 milion lek.

Shpenzimet për riparimin e transformatorëve TL/TM është planifikuar vlere 155 milion Lekë.

Shpenzimet për riparimin e transformatorëve deri 1.8MVA për tension TM/TU është planifikuar vlere 200 milion Lekë.

4.5 Penalitete dhe gjoba

Shpenzimet për penalitete dhe gjoba megjithëse pritet të jenë të larta nuk janë marrë parasysh në përlllogaritjet në tarifë pasi janë përjashtuar metodologjikisht duke u konsideruar shpenzime të eficiencës administrative të shoqërisë.

4.6 Shpenzimet për shërbime koorporative

Përqëndrimi i shërbimeve të grupit në një shoqëri të veçantë brënda grupit ka si qëllim ofrimin e specializuar të këtyre shërbimeve duke rritur cilësinë dhe performancën e shpenzimeve nëpërmjet specializimit të ngushtë duke shfrytëzuar me efikasitet burimet njerëzore dhe informacionet historike që shoqëria OSHEE (si shoqëri mëmë) ka trashëguar.

Ky përqëndrim mundëson uljen e shpenzimeve për njësi të shërbimeve të cilat do të ishin shumë më të mëdha nëse do të organizoheshin drejtpërdrejt nga shoqëritë e ndara (bija).

Në përputhje me objektin e ri të licensuar të aktivitetit OSHEE ka nënshkruar kontratën e shërbimit me OSSH për shërbimet si më poshtë:

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

- Shërbime të Burimeve Njerëzore
- Shërbime Ligjore
- Shërbime të Medias
- Shërbimet Mbështetëse
- Shërbime IT
- Shërbimet Ekonomike
- Shërbime të Zhvillimit të Biznesit

Kosto e shërbimeve korporative, bazuar në kontratat e lidhura, për vitin në vazhdim llogaritet bazuar në planin financiar të shoqërisë për çdo shërbim dhe faturohet për çdo muaj bazuar mbi këtë përlllogaritje, ndërsa vlerësimi përfundimtar vjetor i çmimit të shërbimit bëhet brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës dhe faturohet diferenca.

Kryerja e shërbimeve të përqëndruara nuk ka si qëllim krijimin e fitimit të shoqërisë dhe norma e vendosur e fitimit prej 5% ka si qëllim krijimin e rezervave ligjore dhe të domosdoshme, si dhe investime në rritje të efikasitetit të shërbimeve të ofruara.

4.6.1 Metoda e llogaritjes së kostos së shërbimeve korporative

Metoda e llogaritjes së shërbimeve korporative kalon në 2 faza kryesore:

- a) Llogaritja e kostos totale të shërbimit

Struktura organizative e OSHEE është ndërtuar duke u bazuar në shërbimet e ofruara dhe përbëhet nga:

1. Administrimi i Përgjithshëm (Këshilli Mbikqyrës, Auditim, Njësi zbatim projektsh)
2. Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun (Media)
3. Departamenti i Zhvillimit të Biznesit
4. Drejtoria e Burimeve Njerëzore
5. Drejtoria Ligjore
6. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
7. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
8. Departamenti Ekonomik

Kostot e shërbimeve korporative në shoqërinë OSHEE evidentohen sipas qendrave të kostos bazuar në përbërjen e strukturës organizative të shoqërisë mbi të cilat është ndërtuar edhe evidentimi i kostove në programin financiar SAP.

Pasi merren të dhënat vjetore të evidentuara të kostove sipas secilës nga qendrat e kostos në sistemin SAP bëhet shpërndarja e shpenzimeve të përgjithshme të shoqërisë e cila përfshihet në qendrën e parë të kostos sipas listimit më sipër bazuar në peshën specifike të kostove vjetore të njësive të tjera ndaj totalit të kostos.

Bazuar në kontratën e shërbimit llogaritet edhe kosto e kapitalit të shoqërisë dhe shpërndahet me të njëjtën metodë të peshës specifike të llogaritur.

b) Shpërndarja e kostos së shërbimit për shoqëritë e grupit.

Shpërndarja e kostove të shërbimeve të OSHEE sh.a. për shoqëritë bija bazohet në raportet e shpërndarjes të cilët janë specifike për secilin lloj shërbimi. Llogaritja e shpërndarjes së kostove bazohen në parimet e mëposhtme:

- ✓ Duhet të jenë transparente dhe lehtësisht të kuptueshëm;
- ✓ Duhet të jenë të matshëm;
- ✓ Duhet te pasqyrojnë në masën më të madhe të mundshme një përfaqësim të saktë të përkatësisë së kostove.
- ✓ Ata nuk do të ndër-subvencionojnë në mënyrë të padrejtë kostot midis shoqërive bija dhe do të sigurojnë veçanërisht që kostot që u përkasin shoqërive konkurruese te Grupit, nuk do ti alokohen OSSH SH.A. -së.

Shpërndarja e kostove për secilin nga Shërbimet e ofruara nga OSHEE sh.a. bazohet në treguesit si më poshtë:

- a. *Shërbimet Ekonomike* - bazuar në numrin e transaksioneve të kontabilitetit për secilën prej kompanive (OSHEE, OSSH SH.A., FSHU dhe FTL) në lidhje me transaksionet totale të kontabilitetit të kryera nga ofruesi i shërbimit.
- b. *Shërbimet e Mbështetjes* - bazuar në numrin e punonjësve për secilën prej kompanive (OSHEE, OSSH SH.A., FSHU dhe FTL) në lidhje me numrin e përgjithshëm të punonjësve të Grupit.
- c. *Shërbimet e Teknologjisë së Informacionit* - bazuar në numrin e Përdoruesve të Sistemit të secilës shoqëri në lidhje me numrin e Përgjithshëm të Përdoruesve të Grupit.
- d. *Shërbimet e Burimeve Njerëzore* - bazuar në numrin e punonjësve për secilën prej kompanive (OSHEE, OSSH SH.A., FSHU dhe FTL) në lidhje me numrin e përgjithshëm të punonjësve të Grupit.
- e. *Shërbimet Ligjore* - bazuar në numrin e çështjeve gjyqësore për secilën prej kompanive (OSHEE, OSSH SH.A., FSHU dhe FTL) në lidhje me numrin e përgjithshëm të çështjeve gjyqësore të Grupit.
- f. *Shërbime të Zhvillimit të Biznesit* - bazuar në numrin e punonjësve për secilën prej kompanive (OSHEE, OSSH SH.A., FSHU dhe FTL) në lidhje me numrin e përgjithshëm të punonjësve të Grupit.

- g. *Shërbimet e Medias* - bazuar në kërkesat e shërbimeve të marrëdhënieve me publikun për secilën prej kompanive (OSHEE, OSSH SH.A., FSHU dhe FTL) në lidhje me numrin e përgjithshëm të kërkesave të shërbimeve të marrëdhënieve publike të Grupit.

4.6.2 Llogaritja e shpenzimeve korporative për vitin 2022

Treguesit për ndërtimin e raporteve të shpërndarjes janë paraqitur në tabelën që vijon:

Nr	SHËRBIMI	Raportet e shpërndarjes	Njësia	OSSH	FSHU	FTL
1	SHËRBIME TË MARR. ME PUBLIKUN	Përlllogaritje direkte				
2	SHËRBIME TË ZHVILLIMIT TË BIZNESIT	Numri i punonjesve	Nr.	5,408	846	29
3	SHËRBIME TË BURIMEVE NJERËZORE	Numri i punonjesve	Nr.	5,408	846	29
4	SHËRBIME LIGJORE	Çështje ligjore	Nr.	313	282	9
5	SHËRBIMET MBËSHTETËSE	Vlera e asetëve	000/Lekë	47,195,917	208,920	19,005
6	SHËRBIMET IT	Numri i perdoruesve	Nr.User	1,082	457	10
7	SHËRBIMET EKONOMIKE	Numri i trans.	Nr.Veprimesh	25,504	17,178	1,164

Raportet e shpërndarjes së kostos së shërbimeve për shoqëritë e Grupit që rezultojnë nga përlllogaritja e treguesve të mësipërm paraqiten në tabelën që vijon:

Nr	SHËRBIMI	Raporti		
		OSSH	FSHU	FTL
1	SHËRBIME TË MARR. ME PUBLIKUN	47.51%	52.49%	0.00%
2	SHËRBIME TË ZHVILLIMIT TË BIZNESIT	86.07%	13.46%	0.46%
3	SHËRBIME TË BURIMEVE NJERËZORE	86.07%	13.46%	0.46%
4	SHËRBIME LIGJORE	51.80%	46.66%	1.55%
5	SHËRBIMET MBËSHTETËSE	99.52%	0.44%	0.04%
6	SHËRBIMET IT	69.86%	29.49%	0.65%
7	SHËRBIMET EKONOMIKE	58.17%	39.18%	2.65%

Shërbimet që do të kryhen nga shoqëria OSHEE mëmë për OSSH dhe kostot e këtyre shërbimeve gjatë vitit 2022 parashikohet të jenë si në tabelën që vijon:

(Lekë)

Nr.	PËRSHKRIMI	TOTAL	OSSH	FSHU	FTL
1	SHËRBIME TË MEDIAS	40,505,855	19,244,198	21,261,658	-
2	SHËRBIME TË ZHVILLIMIT TË BIZNESIT	71,667,637	61,686,866	9,649,979	330,791
3	SHËRBIME TË BURIMEVE NJERËZORE	76,969,474	66,250,345	10,363,867	355,263
4	SHËRBIME LIGJORE	183,565,987	95,081,051	85,648,376	2,836,561
5	SHËRBIMET MBËSHTETËSE	484,269,969	481,942,510	2,133,388	194,071
6	SHËRBIMET IT	549,333,054	383,773,272	162,013,411	3,546,372
7	SHËRBIMET EKONOMIKE	103,096,193	59,969,089	40,390,161	2,736,942
	TOTAL	1,509,408,171	1,167,947,331	331,460,840	10,000,000

	ÇMIMI MUJOR I SHËRBIMEVE	125,784,014	97,328,944	27,621,737	833,333
--	---------------------------------	--------------------	-------------------	-------------------	----------------

4.7 Marrëdhënie me Publikun

Shërbimet për marrëdhënie me publikun do të mbulohen kryesisht nga shoqëria mëmë OSHEE ndërsa vlera në shpenzimet operationale planifikohet për një pjesë të vogël të shpenzimeve direkte që lidhet me këtë zë.

4.8 Qera

Si pjesë e shpenzimeve për qera janë shpenzimet për qera të ndërtesave si magazine apo zyra si dhe shpenzimet për qera automjetesh. Vlera e planifikuar e këtyre shpenzimeve për vitin 2022 është bazuar në shpenzimet e vitit 2020 dhe ato të pritshme të vitit 2021.

4.9 Shërbime Postare dhe Komunikimi

